



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.05.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Petrit Vasili - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore publike për sensibilizimin e opinionit publik për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe shfrytëzimi në internet.

Marrin pjesë:

Petrit Vasili, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Arben Kamami, Adelina Rista, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Floida Kërpaçi, Elisa Spiropali, Klodiana Spahiu, Nora Malaj.

Mungojnë:

Bardh Spahia, Flamur Golemi, Nuri Belba, Vangjel Tavo, Halim Kosova, Orjola Pampuri, Grida Shqima, Lindita Metaliaj.

Të ftuar:

Altin Hazizaj – përfaqësues i CRCA-së në Shqipëri dhe Rrjetit për të Drejtat e Fëmijëve
Mirgit Vataj - përfaqësues i Linjës së Telefonit të Ndihmës për Fëmijët, ALO 116
Ervjola Osmanaj – përfaqësuese e Rrjetit Kombëtar të të Rinjve (ANYN)
Rezarta Gjalpi - përfaqësuese e qendrës Fëmijët Sot dhe Rrjeti për të Drejtat e Fëmijëve
Ilsa Dede - përgjegjëse sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Kleopatra Gjika – përfaqësuese e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

Shpat Kolgega – Zëvendësministër i Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Ornela Koleka - drejtoreshë në Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit

HAPET MBLEDHJA

Petrit Vasili – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen.

Sot Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë organizon këtë dëgjese, e cila lidhet me rastin e 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare e Fëmijëve dhe komisioni ka vendosur që ta organizojmë pikërisht në këtë mënyrë, pa hequr asgjë nga gjithçka që promovohet në këtë ditë me të gjitha format e tjera, por duke pasur drejtpërdrejt ata që operojnë në këtë fushë, me qëllimin e vetëm që komisioni të ketë mundësi të marrë sa më shumë informacion nga problematikat, që lidhen me këtë çështje, për të mundësuar më pas të gjitha reflektimet e duhura.

Arsyeja tjetër është që të vëmë në radhën e punëve të parlamentit gjithçka që parlamenti mund të bëjë dhe duhet ta bëjë, në mënyrë që 1 Qershori të jetë një mundësi për të parë dhe monitoruar çfarë gjërash vumë në lëvizje dhe ecën përpara dhe çfarë gjërash të tjera na kanë mbetur akoma pezull. Çështjet që lidhen me të fëmijët bëhen gjithnjë e më shumë delikate dhe disa prej tyre bëhen edhe kritike. Një shoqëri e hapur ka kualitete, të cilat e kanë bërë jetën e të gjithëve neve dhe fëmijëve tanë shumë më të mirë, por njëherazi ka evidentuar edhe problematika, që në emër të kësaj hapjeje, mund të jenë bërë të papërballueshme. Këto i vënë jo pak herë në vështirësi prindërit, të cilët qëndrojnë pranë fëmijëve për të gjetur zgjidhjet e duhura dhe ky mobilizim i madh, mbi të gjitha i shoqërisë civile, është pa asnjë diskutim maja e diamantit për të prerë koracat që krijohen dhe për të ndihmuar sa më shumë, pasi çdo herë që ne humbasim terren, apo jemi një hap mbrapa në lidhje me çështjet e fëmijëve, është një dëm që akumulohet në breza dhe për të cilin nuk do të kemi më kohë ta riparojmë.

Në radhë të parë do të doja të falënderoja të gjithë të ftuarit, që ndodhen këtu, duke filluar nga CRCA-ja, Shqipëria dhe Rrjeti për të Drejtat e Fëmijëve, që përfaqësohet nga zoti Hazizaj.

Mirë se keni ardhur!

Linja e telefonit të ndihmës për fëmijë “Alo 116”, përfaqësuar nga Mirgit Vataj. Mirë se keni ardhur!

Rrjeti Kombëtar i të Rinjve, përfaqësuar nga Ervjola Osmanaj. Mirë se keni ardhur!

Fëmijët Sot dhe Rrjeti për të Drejtat e Fëmijëve, përfaqësuar nga Rezarta Gjalpi. Mirë se keni ardhur!

Nga të ftuarit jo pjesë të ekzekutivit, nuk besoj se ka ndonjë emër që nuk e kam përmendur, me sa kam konfirmuar. Nëse ka, le të më thonë!

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është zonja Ilsa Dede.

Më falni, zonja Dede, në çfarë sektori jeni, sepse na kanë sjellë vetëm që jeni përgjegjëse sektori dhe dua ta citoj të plotë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, e përfaqësuar nga zonja Kleopatra Gjika. A jeni drejtuese e agjencisë, apo jeni specialiste?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, përfaqësohet nga zëvendësministri, zoti Shpati Kolgega. Mirë se keni ardhur! Si dhe Ornela Koleka, drejtoreshë. Mirë se keni ardhur!

Besoj se është momenti të hyjmë në trajtimin e çështjes së sotme. Në rast se nuk ka vërejtje, ta marrin fjalën sipas radhës që unë prezantova. Do të doja që, me mirëkuptimin tuaj, të jemi sintetikë, të përqendrohemi te problemet! Nuk është se po bëj një sugjerim rutinë, që thuhet vazhdimisht, por duhet për të mbajtur sa më të përqendruar vëmendjen e kolegëve deputetë, por edhe të medias që na ndjek, sepse na intereson më shumë të kemi çështje thelbësore, të cilat duan debat këtu dhe angazhim për zgjidhje të mëtejshme, pasi, në këtë mënyrë, jemi më të mirëkuptueshëm për veten tonë dhe për qytetarët që na ndjekin.

Zoti Hazizaj, fjala për ju.

Altin Hazizaj – I nderuar kryetar i komisionit, ju falënderoj në emër të Rrjetit Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri dhe CRCA-së, për organizimin e kësaj seance dëgjimore dhe për përgjigjen pozitive që i bëtë kërkesës sonë në lidhje me një gjë tepër të rëndësishme, siç është siguria në internet e fëmijëve, por edhe e fëmijëve në përgjithësi. Po ashtu unë dua t’ju përgëzoj në lidhje me faktin që kjo seancë dëgjimore zhvillohet në kuadrin e 1 Qershorit dhe, me këtë rast, kam një ftesë në emër të gjithë shoqërisë civile. Në datë 1 Qershor shoqëria civile do të marshojë për të drejtat e fëmijëve, sepse ne mendojmë që, pavarësisht se një pjesë e mirë e fëmijëve jetojnë në kushte shumë të mira, kemi një pjesë tjetër të madhe të fëmijëve, që jetojnë në kushte të rënda dhe që kanë nevojë për ndihmën, mbështetjen dhe kujdesin e të gjithë shoqërisë civile dhe të parlamentit, pa diskutim.

Kështu që keni një ftesë të hapur që t’i bashkoheni manifestimit në datën 1 Qershor në orën 11:00 përgjatë bulevardit “Dëshmorët e Kombit”.

Ashtu siç mund të jeni vënë në dijeni, gjatë dy javëve të fundit, emisioni “Fiks Fare” dhe më pas shumë medie serioze shqiptare, kanë paraqitur gjendjen tepër të rëndë, për të mos thënë skandaloze, të sigurisë së fëmijëve në internet. nga viti 2013. Unë po i përmend statistikisht: 44% e fëmijëve të pyetur nga një pyetësor tepër serioz, shohim materiale

pornografike çdo ditë, 47% e fëmijëve të intervistuar pranojnë se gjatë vitit të fundit janë kontaktuar nga një individ i panjohur *online*, po ashtu 47% e fëmijëve thonë se janë kontaktuar vetëm vitin e fundit nga një i njohur, ndërsa 40% e tyre janë kontaktuar nga persona tërësisht të panjohur. Ndërkohë 62% e fëmijëve të intervistuar konfirmojnë se kanë shokë të cilët vizitojnë faqe pornografike.

Ajo që ndodh, për ta shpjeguar shkurtimisht, është fakti se Kodi Penal dhe një pjesë e mirë e ligjeve shqiptare i mbrojnë fëmijët vetëm nga pornografia dhe dhuna seksuale. Gjithçka që ndodh *online*, pra në një botë virtuale, nuk është e mbuluar nga Kodi Penal. Për këtë qëllim ne kemi punuar që nga viti 2015 e në vijim bashkë me një sërë ministrish. Unë jam shumë i lumtur që kemi këtu përfaqësues nga Ministria e ish-Mirëqenies, që tashmë është Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe nga Ministria e Brendshme, për të ndërtuar një plan kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve në internet, i cili ka hyrë në fuqi. Kjo vlen për t'u përgëzuar dhe unë do të doja që të merreshin vërtet në konsideratë. Ndërkohë çështjet të cilat na mbeten të pazgjidhura, unë po i drejtoj te Kodi Penal dhe do të doja t'ju jepja sot propozimet ligjore të plota, që ne kemi, si organizatë, për sa i përket përmirësimit të Kodit Penal.

Po i marr një nga një propozimet që kemi bërë dhe që do t'ju japim zyrtarisht.

Marrëdhënia seksuale me fëmijët.

Mënyra si Kodi Penal e rregullon këtë marrëdhënie paraqet probleme serioze. Rekomandimi i Komitetit për Drejtat e Fëmijës që prej vitit 2010 ka qenë se Shqipëria ka nevojë të përmirësojë përmbajtjen e legjislacionit, pra jo vetë ligjin, por përmbajtjen e këtij ligji. Një vepër e re penale, të cilën e kërkojmë që të përfshihet në Kodin Penal është shtytja dhe përgatitja e fëmijës për të hyrë në një marrëdhënie seksuale. Në anglisht përdoret fjala *grooming*, që do të thotë një i rritur, që përgatit fëmijën të hyjë në marrëdhënie seksuale dhe duket sikur është fëmija që ka kërkuar marrëdhënie seksuale dhe jo i rrituri. Pra, përdoren metoda të manipulimit ose të nxitjes së fëmijës për të kryer marrëdhënie seksuale. Po ashtu janë kaq problematike të dhënat që do të prezantojë “Alo 116” pak më vonë, që kanë të bëjnë me komunikimin me fëmijën për qëllime seksuale. Fëmijët marrin mesazhe në *facebook*, në rrjete sociale, por njëkohësisht edhe në celularët e tyre me përmbajtje seksuale. Kodi Penal nuk i dënon personat e rritur, që kanë mbushur moshën e përgjegjësisë penale, për dërgimin e mesazheve të tilla.

Një çështje tjetër, që na ka bërë përshtypje, është fakti se Kodi Penal nuk e ndëshkon ngacmimin seksual, që do të thotë se ajo që ne shohim me shqetësim është një armatë e gjerë djemsh dhe burrash, të cilët qëndrojnë pranë gjimnazeve, shkollave 9-vjeçare dhe janë grabitqarë seksualë në kuptimin e plotë të fjalës, ngacmojnë vajza të vogla, vajza të reja, zonjat,

nënat dhe mësueset tona me romuze dhe fjalë nga më të ndryshmet seksuale. Është e patolerueshme që dikush të të ngacmojë seksualisht. Kodi Penal nuk e ka këtë si vepër penale, prandaj kërkojmë që kjo të shtohet.

Një gjë tjetër që prezantojmë sot është se Kodi Penal rregullon vetëm marrëdhëniet seksuale me dhunë dhe jo marrëdhëniet seksuale pa dëshirë, me kërcënim, apo duke mashtruar dhe kjo bën fjalë për dy momente kryesore: e para për të miturit e moshës 14 deri në 18 vjeç, djem dhe vajza, por, pa diskutim edhe për të rriturit, sepse janë vepra penale që ndikojnë në mirëqenien fizike të çdo individi.

Ndërhyrja e parafundit që ne rekomandojmë në Kodin Penal, është mbrojtja e fëmijëve dhe e të miturve nga pornografia. Në vitin 2013 parlamenti ka bërë, me të drejtë, një përmirësim të nenit 117 të Kodit Penal, megjithatë neni përsëri la disa hapësira për të abuzuar. Nga ana tjetër nuk bëhet e qartë në tekstin aktual të Kodit neni 117, nëse kjo lloj pornografie ndodh *online*, apo është pornografi e modelit të vjetër, e cila vinte nëpërmjet kasetave, fotove etj. Pra, kemi nevojë të zgjerojmë kuptimin e të gjithë veprës penale për të përfshirë edhe pornografinë, që sot, në shumicën e kohës, ndodh e gjitha *online*.

E fundit, është përdorimi i paautorizuar dhe vjedhja e identitetit. Kodi Penal parashikon si vjedhje të identitetit vetëm atë që quhet identitet fizik, pra karta e identitetit, pasaporta dhe del që një person ka pasaportë me emrin Altin Hazizaj. Nuk ka marrë parasysh, dhe kjo është e kuptueshme pse, kur kjo vjedhje identiteti ndodh në internet, si: vjedhja e identitetit në *facebook*, apo *twitter*, BE-ja ka rekomanduar prej vitesh që të gjitha këto vepra penale, që ndodhin në internet, të rregullohen në Kodin Penal.

Ajo që dua të them në përfundim, është se të gjitha propozimet vijnë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Shqipërisë, pra me nenin 53 “Mbrojtja e posaçme dhe e veçantë për fëmijën”, dhe me rekomandimet dhe direktivat e BE-së. Ne kërkojmë që legjislacioni shqiptar të përputhet me *acquis communautaire*, të cilat janë tepër të rëndësishme dhe ne i raportojmë.

Së fundmi, unë doja të bëja një falënderim publik për kurajën që kanë mediet! Në veçanti do të doja të falënderoja emisionin “Fiks Fare”, sepse gjate dy javëve të fundit ne kemi punuar bashkë për të denoncuar të gjithë grabitqarët seksuale, që në Shqipëri mashtrojnë dhe pa diskutim që abuzojnë me fëmijët seksualisht.

Së fundi, kam një ftesë të hapur për të gjithë deputetët, nuk e kam kritikë, që të mos kujtohen për fëmijët vetëm në datën 1 Qershor, sepse fëmijët kanë nevojë për mbrojtjen dhe për kujdesin tonë çdo ditë të jetës së tyre.

Faleminderit!

Petrit Vasili –Faleminderit, zoti Hazizaj!

Unë kam një pyetje shumë të shkurtër, vetëm për të hedhur dritë mbi këtë çështje, pasi pjesa e parë e parashtrësës suaj, konstatimet, për mua janë kritike dhe nuk janë konstatime të thjeshta. Shifrat e paraqitura janë vërtet dramatike, por edhe sikur të kishin qenë disa herë më të ulëta përsëri do të kishin qenë shifra kritike. Pra, bëhet fjalë për një rend 40 e ca përlind, që është vërtet një situatë dramatike. Njëherazi, lidhur me ndryshimet që ju sugjeroni në Kodin Penal, janë shumë të qarta dhe nuk lenë shumë hapësira për të komentuar. Unë doja të dija: a janë paraqitur më parë nga ana juaj këto ndryshime? A kanë një histori të tyre, apo sot është momenti ku ju i keni përmbledhur për t'i diskutuar të gjitha së bashku? A është tentuar edhe më parë për t'i paraqitur dhe nuk kanë arritur të reflektohen? Për ne ka rëndësi edhe mënyra se si do t'i adresojmë.

Altin Hazizaj - Zyrtarisht ka një histori. Për herë të parë këto propozime janë diskutuar me përfaqësuesit e Komisionit të Ligjeve, njëkohësisht edhe me grupin "Miq të fëmijëve", flasim gjithmonë para zgjedhjeve të vitit 2017, pra në vitin 2016. Më pas, me ndryshimet që iu bënë Kodit Penal në vitin 2017, u përfshinë disa vepra të reja penale. Ne kemi kërkuar dhe i kemi paraqitur zyrtarisht propozimet tona, të cilat, të them të drejtën, ndryshuan shumë pak.

I vetmi ndryshim që u bë nga viti 2017 deri në vitin 2018 është çështja e ngacmimit seksual, sepse ka pasur disa diskutime se si mund të rregullohej kjo vepër penale. Pra, do të thotë se ka një histori të gjatë. Së fundi,...

Petrit Vasili – Por nuk kanë gjetur reflektim.

Altin Hazizaj – Jo.

Petrit Vasili – Kjo për të qenë të qartë me të gjithë kolegët.

Altin Hazizaj – Në vitin 2017, në seancën dëgjimore që u realizua nga Komisioni i Ligjeve, në mos gaboj, edhe në kuadër të reformës së madhe të drejtësisë, na u dha një përgjigje që Kodi Penal kishte ndryshuar aq shpesh dhe për momentin nuk ishte e përshtatshme të përfshiheshin këto ndryshime. Në atë kohë bëhej fjalë përafërsisht për 12-13 ndryshime të rëndësishme në Kodin Penal. Ajo që ne vëmë re është fakti se gjatë viteve 2017-2018 vazhdojnë raportimet e rasteve të rënda të manipulimeve, të shfrytëzimeve dhe të ngacmimeve online të fëmijëve. Pra, në qoftë se ka një urgjencë, e cila sot nuk pret, janë ndryshimet në Kodin Penal për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna seksuale dhe ngacmimet seksuale që ndodhin online.

Petrit Vasili – Dua të bëj një sqarim shumë të shkurtër.

Është e vërtetë që Kodi Penal është prekur shumë herë. Ka pasur edhe momente kur prekjet e tij kanë qenë jo gjithmonë të përcaktuara qartë. Gjithashtu, ka pasur edhe rëndime të dënimeve, të cilat mund të mos ishin të tilla, unë personalisht jam i gatshëm dhe nuk kam asnjë dyshim që të gjithë kolegët e ulur në këtë tavolinë do t'ju mbështesnin. Sigurisht, secili nga kolegët në këtë tavolinë ka opinionin e tij dhe mund të shprehet në mënyrë individuale, jo se

kam ndonjë rezervë unë personale për ndonjërin prej tyre, por 90% e parashtrësës që ju bëtë mendoj se janë nevoja emergjente. Unë e kam dëgjuar edhe diskutimin që ju keni bërë në atë kohë, në kuadrin e paketës së reformës në drejtësi. Ka qenë një qasje mendjembyllur në atë kohë, pasi ne po e preknim Kodin për detaje të tilla si data e të tjerë, pra për gjëra që nuk kishin nevojë të ndërhyhej dhe që rezultuan të pamundura për t'u realizuar. Ndërkohë, ne mund t'i kishim adresuar me kohë këto problematika. Sipas mendimit tim, kemi humbur kohë të çmuar, sepse fenomeni ecën me galop dhe është e qartë se ky negativitet ecën shumë më shpejt se veprimet tona. Megjithatë po e mbyll këtu. Unë ju falënderoj sinqerisht!

Altin Hazizaj – Unë mendoj se çështjet seksuale nuk presin dhe kjo është vërteta. Pra, as fëmija nuk pret dot dhe as grabitqarët seksualë nuk presin dot.

Petrit Vasili – Pikërisht për këtë po flas.

Altin Hazizaj – Pra, çështja është se ne duhet të mendojmë më të mirën për Kodin Penal se kur duhet ta bëjmë Kodi i ri. Gjithashtu, duhet të mendojmë se grabitqarët nuk presin dhe në këtë moment, që jemi duke folur ne këtu ata janë duke abuzuar me ndonjë fëmijë.

Petrit Vasili – Meqenëse ne shkëmbejmë opinionet tona, për mua kur u rëndua armëmbajtja pa leje në Kodin Penal nga 1 vit u bë 1 vit e gjysmë apo nga 2 vjet u bë 2 vjet e një muaj, le të bëhet, nuk kam qenë asnjëherë pishman dhe kam votuar pro. Ndërkohë, për një dëm që u bëhet fëmijëve në këto shifra, ku 44% e fëmijëve shikojnë pornografi e të tjerë, të mos japin dënimin ekstrem për sa u takon të gjitha problemeve, që lidhen me këtë çështje, kjo është absurde! Shumë në detaje është paraqitur në Kodin Penal pedofilia e pastër. Ne bëjmë shumë gjëra për barazinë gjinore, ndërkohë që ngacmimi arrogant dhe agresiv, në mënyrë të veçantë ndaj femrave, është sot një fenomen. Sigurisht, këto gjëra janë të adresuara, por, pa diskutim, do të shikojmë edhe të gjitha mekanizmat, që kjo nismë të ecë përpara, duke parë ato pjesë, të cilat nuk kanë mundur të reflektohen dot. Sigurisht, me dakordësinë e të gjithëve, pasi kodet janë gjithmonë një nismë e rëndësishme e madhe, që kërkojnë mirëkuptimin e të gjithëve. Duket qartë se të gjithë deputetët e Kuvendit të Shqipërisë kanë ndjeshmëri të lartë për këtë çështje.

Unë e kuptoj se ndonjëherë veprimtaria e zakonshme, formale dhe burokratike krijojnë vështirësitë e saj, por nuk besoj se kjo çështje duhet të mbetet pa gjurmë, në mënyrë të veçantë për këtë pjesë konkrete.

Zoti Xhelilaj keni fjalën.

Roland Xhelilaj – I përshëndes të gjithë të ftuarit dhe shpreh konsideratën për punën që bëni në drejtim të ndihmës për fëmijët, në mënyrë që ata të rriten jo thjesht të shëndetshëm, por që të përgatiten për të përballuar situatat që sjell jeta në vazhdim.

Në vazhdim të asaj që ngriti Altini me të drejtë, kam vetëm një merak lidhur me kalimin direkt te Kodi Penal. Duket sikur i gjithë problemi që ju keni lidhet me disa ndryshime në Kodin Penal, që do të bëjnë të mundur eliminimin e këtij rreziku që vjen për fëmijët nga “grabitqarët seksualë”, siç i quajti Altini, të cilët janë të gatshëm të sulmojnë në çdo kohë.

Unë personalisht mendoj se pjesa e Kodit Penal është pa diskutim e rëndësishme, me mbështetjen tonë totale. Unë nuk e di se çfarë lidhje ka ndërhyrja e shpeshtë për ta penguar, nuk arrij ta kuptoj, por besoj se këtu ka vend për reflektim edhe nga Komisioni i Ligjeve. Në qoftë se është e nevojshme ndërhyrja, sidomos kur bëhet fjalë për fëmijët, duhet bërë.

Unë kam dëshirë që ju të shprehnit opinionin tuaj lidhur me luftën që kërkon të bëni ndaj këtij fenomeni dhe çfarë nevojë keni nga ana jonë, si deputetë? Pra, jo vetëm nëpërmjet jush, por edhe nëpërmjet nesh dhe televizionit, t’u drejtohem i gjithë familjarëve, jofamiljarëve dhe institucioneve, në mënyrë që të rrisin kujdesin për fëmijët dhe si duhet të rritet ky kujdes, për të eliminuar disa elemente që nuk kanë lidhje me Kodin Penal. Çfarë do të bëjë Kodi Penal lidhur me shifrën 44% të fëmijëve të pyetur, të cilët shikojnë materiale pornografike? Fëmijëve duhet t’u themi se është problem, se është një veprim shumë i keq, por, në fund të fundit, t’u themi edhe se do të dënohen, në mënyrë që ata të arrijnë ta kuptojnë dhe të bëjnë një ndryshim në këtë drejtim. Gjithashtu, 62% e fëmijëve që janë intervistuar kanë thënë se kanë shokë, të cilët shikojnë pornografi. Ky fenomen, që për mendimin tim mund të mos jem totalisht i saktë, por duke qenë se është një problem që na dhemb të gjithëve, sepse ka lidhje direkte dhe indirekte me fëmijët dhe me shoqërinë, kërkon që ju të reflektoni disa gjëra, të cilat, me përvojën dhe punën tuaj, kanë dalë në pah dhe kanë nevojë për mbështetje specifike nga institucionet e të gjitha niveleve, duke filluar nga shkollat deri tek organet e qeverisjes vendore, organet e qeverisjes qendrore, te deputetët e të tjerë. Patjetër që në fund është edhe Kodi Penal, ku policia dhe të gjitha institucionet ligjzbatuese problemin e fëmijët e kanë në qendër të vëmendjes, por e mira do të ishte që ta kenë edhe me detyrim ligjor. Për këtë e kisha se m’u duk sikur po i hyjmë Kodit Penal. Besoj jemi të gjithë dakord që Kodi Penal, me ato propozime që bëni ju dhe me vëmendjen e Komisionit të Ligjeve, por edhe me kontributin tonë, të hyjë në rrugën e ndryshimit dhe të shpresojmë që rezultatet të jenë të tilla që 1 Qershorin tjetër të merremi me probleme më pak të rrezikshme për fëmijët tanë.

Më mirëkuptoni! Edhe një herë shpreh konsideratën për të gjithë përpjekjen që ju bëni!
Ju falënderoj!

Petrit Vasili – Po, zonja Malaj.

Nora Malaj – Faleminderit, zotin kryetar!

Së pari, do të doja të falënderoja të gjithë ekipin, që ka ardhur këtu, i cili ka një nga përvojat më të mira në drejtim të kësaj fushe dhe në drejtim të ngritjes së një modeli shumë të

mirë në kuadër të një plani kombëtar për luftën për parandalimin e të gjitha situatave që sot shfaqen këtu!

E dyta, duke ardhur nga fusha e edukimit dhe duke qenë pjesë e përbashkët e disa nga nismave dhe aksioneve, që i kemi nisur dhe janë rrugës, unë do të mendoja që takimi i sotëm dhe kjo dëgjese lidhen me dy momente shumë të rëndësishme. Lidhen me një fakt shumë të trishtë, që kemi parë para dy ditëve në një nga mediet ku një i rritur pedofil, i sëmurë mendor, kryente akte seksuale pas një oborri të shkollës në qytetin e Kavajës, ndoshta në orën 1 e 15 e ditës, një rast ky i paprecedent dhe jashtëzakonisht shumë i rëndë dhe mendova se e gjithë shoqëria do të ngihej, se rrjetet sociale do të kishin arritur në britmën më të madhe për të thënë “Ku po shkojmë?!” dhe se çdo individ, përtej qasjes politike, do të kuptonte që rreziku është shumë real dhe jo më virtual. Konstatimi i shifrave që keni sjellë sot, ndonëse ministritë e linjës kanë bërë një marrëveshje në kuadër të parandalimit dhe të luftës për të siguruar standardin e fëmijëve në përdorimin e aksesit të internetit, edhe si element për nevojën që ata kanë gjatë procesit të mësimdhënies apo të edukimit, tregon që ne jemi ende në vend numëro, për fatin tonë të keq. Pra, jemi në fazën që e konstatojmë si fenomen, por nuk kemi gjetur shkakun dhe të analizojmë pasojat. Sigurisht janë momente shumë të rëndësishme, për të cilët duhet bërë ndërhyrje emergjente, prandaj falënderoj të gjithë komisionin këtu për ndjeshmërinë që ka dhe për qartësinë që duhet të marrim për disa nisma jo vetëm ligjore, por edhe akte në vijimësinë e saj, pra për ta monitoruar nismën ligjore dhe për të parë përtej ndryshimit të kodit. Unë do të propozoja një plan kombëtar me emergjencë të lartë jo vetëm në 4 institucionet e linjës, por duke futur edhe institucionet e pushtetit lokal, si një pushtet shërbimesh, që ka një domosdoshmëri dhe një nevojë të dedikuar për kapitalin human, që lidhet me kategorinë e fëmijëve. Këta fëmijë nuk janë më përdorues vetëm në sistemin parauniversitar, por fillojnë që në parashkollor, pasi procesi e prindërimit, i edukimit dhe i përdorimit të *I-Phone*-it nga prindërit që në moshën nga 0 deri në 3 vjeç është bërë aq permanent saqë sot fëmija, edhe në moshë shumë të vogël, është në gjendje ta përdorë që në momentin e parë internetin pa ditur, më pas me dije, por duke mos ditur se cilat janë fashat.

Propozoj që pjesë e organeve që merren me vendimmarrjen dhe me fashimin e të gjitha lojërave të internetit nëpër qytete, e sidomos me hapjen e qendrave të basteve pranë shkollave, e cila është kthyer në një gangrenë të jashtëzakonshme, ku të rinjtë janë pjesëmarrës dhe që sot po kthehet në sëmundjen e shekullit, të bëhet edhe ky komision, sepse e ka për detyrë ta trajtojë këtë gjë. Në qasjen për të mos i ikur problemit mendoj se është shumë e rëndësishme të fuqizojmë tre mekanizma që lidhen me pushtetin lokal, me institucionet shtetërore, me drejtoritë dhe me institucionet e shërbimeve, si dhe me institucionet psikosociale të punës reale, duke futur një kategori të katërt, që quhet prindërimi.

Element shumë i vështirë dhe shumë problematik, që ende nuk e kemi rregulluar në bazën ligjore lidhet me rolin e prindërimit dhe cili do të jetë ai në kuadrin e një rasti si ai i 6 vajzave, që u paraqit dje, të cilat kanë ngelur jetime dhe ku institucionet shtetërore duhet të veprojnë përtej faktit të solidaritetit social; kemi rastet kur këta mund të bëhen pre në kuadër të luftës kundër bullizmit dhe këtu komisioni duhet të marrë një iniciativë për të parandaluar bullizmin, ndoshta do t'jua kërkoj këtë si një nevojë imediate për ta parë si një sfidë të përbashkët, ku ju mund të na ndihmoni për rastet e parandalimit të bullizmit ku futet edhe siguria e internetit që është një ndër faktorët determinues për ta bërë sa më të mirë jetën e të rinjve.

Mendoj se përtej kodit dhe ndryshimeve, që unë i quaj adekuate dhe për të cilat duhet të marrim masa, duhet të realizojmë një frymë kombëtare, pra për ta ngritur për ta ndryshuar qasjen në komunitet, për ta orientuar shoqërinë drejt nevojës që ka, se cikli i jetës është i ndryshëm, nuk mund të rikthehesh prapë të bëhesh edhe fëmijë, edhe i rritur dhe i plakur. Pra, në këto cikle dhe stade kemi shumë nevojë të ndryshojmë edukimin e komunitetit për ta parë këtë si një problem mbarëkombëtar, prandaj do ta quaja shumë të nevojshme.

Duke ju falënderuar për informacionin, mendoj se duhet të gjejmë rrugët e zgjidhjes në mënyrë që ky komision të luajë rolin e tij në monitorimin e zbatimit të nevojës për të parandaluar dhe për të siguruar këtë standard dhe cilësi jetese.

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Malaj!

Në qoftë se nuk ka ndërhyrje tjetër, fjalën e ka zoti Mirgit Vataj. E njëjta ftesë, sikurse për zotin Hazizaj. Ju lutem sa më shumë konciz!

Mirgit Vataj – Faleminderit!

I nderuar, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Realisht e gjejmë me shumë vend organizimin e kësaj seance ditën e sotme, e cila është shumë e rëndësishme për ne.

Që nga viti 2009, ne u kemi kushtuar një vëmendje të veçantë çështjeve të sigurisë *online*, duke qenë se ne jemi shërbimi i vetëm kombëtar 24-orësh për fëmijët, çdo ditë të javës. Pra, duke u nisur nga tipologjia dhe rastet që kemi trajtuar, ne e kemi pasur gjithmonë në qendër të vëmendjes dhe shqetësim permanent të punës sonë sigurinë *online*, duke qenë se fenomeni i internetit dhe çështjet e sigurisë *online* të fëmijëve, janë çështje të reja faktikisht, në të njëjtën kohë edhe pjesa institucionale, pjesa ligjore janë të papërgatitura për të trajtuar raste të tilla. Unë do të përpiqem t'ju tregoj me shifra konkrete raste, të cilat kanë ardhur pranë shërbimit tonë, ku vetëm gjatë vitit 2017 kemi trajtuar rreth 500 raste për bulling, talljeve *online*, varësisë në internet dhe raste të ndeshjes së pornografisë me të mitur.

Pra, janë këto disa nga çështjet që i kemi trajtuar gjatë vitit 2017 vetëm nëpërmjet telefonatave, ku fëmijët kanë raportuar dhe kanë referuar raste pranë linjës sonë. Në të njëjtën kohë, në bashkëpunim me CRCA-në, kemi ndërtuar dhe menaxhojmë një platformë, e cila quhet platforma “*E sigurt.al*”, ku raportohen dhe trajtohen rastet e çështjeve që kanë të bëjnë me abuzimin në internet të fëmijëve. Në të njëjtën kohë, duke qenë se nuk ka një qendër burimore të mirëfilltë për sa u takon çështjeve të sigurisë *online*, menduam që këtë platformë ta kthejmë edhe në një qendër burimore. Pra, që nga viti 2016, kur është krijuar kjo platformë, janë raportuar më shumë se 150 raste që kanë të bëjnë kryesisht me sigurinë *online* të fëmijëve, që janë ekspozim ndaj imazheve apo materialeve me përmbajtje seksuale, janë 51 raste të raportuara, raste të saj për buling 74, raste të bulizmit në telefon 13, pornografi me të miturit në internet 4 dhe në të njëjtën kohë sms dhe postime të tjera ofenduese, 8 raste.

Përveç këtyre rasteve të raportuara nuk duhet të harrojmë edhe dy ngjarje që janë vërtet shqetësuese, ku fëmijët, të cilët kanë raportuar rastet problematike të bullizmit, të talljeve *online* kanë kryer fatkeqësisht vetëvrasje në Shqipëri. Kjo është ajo që duhet të na shqetësojë përtej fakteve të tjera dhe këto janë shqetësimet reale që ndeshim dhe që i kemi trajtuar gjatë këtyre viteve.

Për sa i përket Kodit Penal. Pse është e rëndësishme të ndërhyhet në Kodin Penal? Është e rëndësishme të ndërhyhet në Kodin Penal, sepse shqetësimi ynë kryesor ka të bëjë edhe me aspektin e logjistikës për kapjen, për identifikimin e personave, të cilët kryejnë kryesisht krime seksuale ndaj fëmijëve. Në të gjitha rastet që kemi raportuar në Policinë e Shtetit, fatkeqësisht jo për shkak të vullnetit të Policisë së Shtetit, por për shkak të logjistikës dhe të mënyrës se si i klasifikon Kodi Penal çështjet, policia e ka pasur të pamundur për të iniciuar hetime dhe ndjekje penale. Më e keqja është se vetëm në Tiranë ka një njësi për krimin kibernetik, ndërkohë në rrethe dhe në drejtoritë e qarqeve nuk ka njësi të mirëfillta për krimin kibernetik. Pra, një njësi me dy veta, me një volum rastesh shumë të mëdha në Tiranë nuk mund të bëjë dot asgjë. Në të njëjtën kohë, për sa i përket, zonja Malaj, e përmendi pak më parë, të cilën fatmirësisht e kemi pasur mike dhe aleate shumë të mirë edhe gjatë kohës kur ka qenë zëvendësministre arsimit, neve na ka ndihmuar. Gjatë gjithë këtyre viteve ne kemi ndërmarrë disa fushata shumë të rëndësishme gjatë të cilave kemi ndeshur shumë raste që i kemi raportuar në material. Pra, ka qenë një mekanizëm i mirë për të ndërgjegjësuar fëmijët, për ta përdorur internetin në mënyrë të sigurt, por në të njëjtën kohë edhe për të na raportuar raste. Në të njëjtën kohë ne vazhdojmë fushatën, sigurisht po prapë në bashkëpunim me ministrinë e Arsimit dhe fatmirësisht e kemi pasur aleate gjatë zhvillimit të fushatave. Në të njëjtën kohë përveç fushatave që kemi organizuar para dy vjetësh para se të inicionin platformën *.al* dhe në bashkëpunim me CRCA-në, të njëjtin eksperiment të bërë para dy vjetësh, e kemi bërë sërish.

Besoj se ka qenë një ndër nga format më të mira për të kuptuar se çfarë po ndodh në dhomat e chat-i. Ne u prezantuam si një vajzë 14 vjeçe që futet në komunikim me persona të rritur, në mbi 10 raste, persona mbi 30 vjeç u futen në komunikim me ne duke kërkuar akte seksuale. Vetëm në një rast një person refuzoi që të kontaktonte me ne, duke pasur frikën e ligjit dhe jo të faktit që nuk duhet të futesh në marrëdhënie seksuale me fëmijët. Të njëjtin eksperiment bëri edhe “Fiks fare” këto ditë, ne e falënderojmë që e solli këtë në vëmendje, por duhet të kuptojmë që ndërgjegjësimi i personave është i rëndësishëm.

Ne kemi dyshime që mund të ketë rrjete pedofilësh, të cilët mund të jenë duke përdor teknologjinë për të rekrutuar viktimën e tyre seksuale. Është pak e rëndë kur e thua këtë. Hipotetifikisht ne nuk jemi të mbrojtur, por ka shoqëri që janë tepër të zhvilluara, kanë mekanizma tejet të avancuar të mbrojtjes dhe në të njëjtën kohë po ndeshen me rrjete pedofilësh. Kështu që edhe dyshimi jonë është tejet i arsyeshëm duke qenë se këta janë persona që futen në komunikim dhe shfrytëzojnë dhomat e chat-it për të komunikuar me fëmijët. Pra, ata janë të mirorganizuar dhe të lidhur me njëri-tjetrin. Këto janë dyshimet që ne kemi, të cilat ia referuam prokurorisë, por, duke qenë se ne nuk e kishim nisur sipas procedurave, nuk u morën për bazë. Ndaj, duke pasur të gjithë këto problematika, unë kam përgatitur një sërë rekomandimesh që i referohen ditës së sotme, nevojës sonë si shërbim, por edhe nevojës së gjithë sistemit për të përmirësuar situatën e mbrojtjes së fëmijëve *online*, që kanë të bëjnë me mbështetjen institucionale të shërbimeve profesionale, që mbrojnë fëmijët në rastet e abuzimeve në internet, siç është *Alo 116*, dhe *i sigurt.al*. Të mos harrojmë që ne jemi shumë mbrapa. Kemi një nen në ligjin e ri të fëmijëve, që është neni 68, që flet për mekanizma që u referohen mbrojtjes së fëmijëve, ku linja e telefonit shihet si një shërbim tejet i rëndësishëm që u krijon mundësinë, në të njëjtën kohë është edhe direktivë e Bashkimit Europian, që nga viti 2007, secili vend do të ketë një linjë këshillimi për fëmijët. Fatmirësisht, ne kemi qenë vendi i parë jo anëtar i Bashkimit Europian që kemi implementuar një shërbim telefonik për fëmijët 24 orë falas, i publikuar në të gjithë Shqipërinë, gjithashtu në vitin 2013 ka një rezolutë të parlamentit për mbështetjen e *Alo 116*, që fatkeqësisht deri tani nuk është zbatuar. Edhe ligji i ri edhe mënyrat e tjera duhet të mbështeten.

Tani dua të ndalem pak edhe te një propozim që bëri një deputet, që, përveç rregullimit të Kodit Penal, duhet të mbështesim ato shërbime që ofrohen për fëmijët dhe ato shërbime, të cilat i janë të dedikuara tërësisht për mbrojtjen e fëmijëve *online*. *Alo 116* dhe platforma *i sigurt.al* janë dy mekanizmat e parë, të cilët trajtojnë dhe mbrojnë fëmijët, të cilët janë viktimat e dhunës, por shërbejnë edhe si mekanizma të para ndalimit dhe mbrojtje së fëmijëve nga dhuna në internet.

Sigurisht ka nevojë për llogaridhënie të ministrive të linjës. Ministria e Arsimit duhet të publikojë të dhëna për bulizmin që raportohet nga shkollat, të ndërtojë një mekanizëm për luftën ndaj rasteve të bulizmit, qoftë edhe sa raste kanë trajtuar psikologët.

Me këtë rast, dua të falënderoj zotin Kolgega pjesëmarrës për bashkëpunimin që kemi pasur për organizimin e fushatave të përbashkëta! Ministria e Shëndetësisë duhet të bëjë hapa përpara për ta trajtuar dhe pasur në qendër të vëmendjes, për shkak të nevojave të jashtëzakonshme që ka sot sistemi për mbrojtjen e fëmijëve *online*. Ministria e Mbrojtjes, gjithashtu, duke qenë se një nga prioritetet e NATO-s është mbrojtja kibernetike, duhet që edhe Ministria e Brendshme ta ketë në pararojë të punës së saj çështjen e sigurisë *online*, kryesisht të fëmijëve si një nga grupet më të marginalizuara, por edhe më të viktimizuara të dhunës *online*. Nisur nga rastet e trajtuara nga policia, mendojmë se policia nuk i ka kapacitetet dhe burimet e duhura për të përballuar të gjitha çështjet e sigurisë *online* të fëmijëve, përfshirë këtu bulizmin dhe shtrëngimin për t'u përfshirë në sjellje të rrezikshme. Në qoftë se ju do të bëni një eksperiment të tillë, ne kemi pasur disa raste të raportuara të talljes *online*, ku kemi video të publikuara me mbishkrime dhe epitete nga më të ndryshmet për fëmijë vajza dhe fëmijë djem me muzikë nga më të ndryshmet, ku ne falë bashkëpunimit që kemi në *youtube* në mënyrë direkte arrijmë të heqim videot, ndërsa policia nuk mundet dhe nuk ka asnjë kapacitet për t'i hequr këto video.

Në të njëjtën kohë problemi qëndron, pasi ne ndonjëherë duhet të marrim edhe rolin e negociatorit, pasi ne si zyrë kemi negociuar shpesh pjesën e marrëdhënieve që ka policia e shtetit me ISP-të, pra me ofruesit e shërbimit të internetit, sepse shpeshherë këto kompani nuk e tregojnë përdorimin fundor të IP-së nga ku ngarkohen këto materiale. Besoj se ka një kod etik dhe duhet ta kenë për detyrë të raportojnë gjithmonë pjesën e IP-së fundore të përdoruesit, i cili ngarkon materialet që janë të rrezikshme dhe të dëmshme për fëmijët.

Gjithashtu, ne nuk mund ta përdorim Kodin Penal, aktualisht në formën në të cilën ndodhet, nuk mund të klasifikojmë rastet, të cilat na raportohen dhe janë vepra të pastra penale ndaj fëmijëve, pasi nuk e klasifikojmë dot Kodin Penal. Madje, nga momentet që ne i kemi trajtuar rastet me Policinë e Shtetit ka pasur edhe momente shumë qesharake nga mënyra se si i perceptonin dhe se si duhej t'i klasifikonin rastet e talljeve *online* të fëmijëve. Pra, në të njëjtën kohë rekomandohet edhe zbatimi i një procedure standarde nga institucionet shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, për ndjekjen, raportimin dhe trajtimin e rasteve të shfrytëzimit dhe të abuzimit *online*, nevojitet një mbrojtje ligjore për ruajtjen e identitetit të fëmijëve dhe në botën virtuale, gjithashtu edhe promovimi i platformave kombëtare të informimit, të raportimit mbi sigurinë e fëmijëve në internet dhe shërbimet kombëtare, siç mund të jenë “*I sigurt.al*”, “*Alo 116*”. Pra, të gjitha këto forma, të cilat besojmë se e bëjmë

problematike situatën, por në të njëjtën kohë ndihmojnë në sigurimin dhe parandalimin e rasteve të dhunës dhe të shfrytëzimit të fëmijëve në internet.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit, zoti Vataj!

Kisha një konstatim të përbashkët për të dyja prezantimet, duke iu kthyer përsëri çështjes së aspektit ligjor, jo vetëm Kodit Penal, sepse ju e dini që së bashku me Kodin Penal ka edhe disa ligje të tjera që lidhen me të. Sot jemi përpara dy raportimeve shumë të rëndësishme, me shifra shumë të mëdha, në të cilat ka një diferencë të madhe, jo për ju, por për realitetin. Ju referoni raste të shumta dhe të pafundme, pjesa më e varfër, jo juaja, është se cilët janë fajtorët dhe si dënohen? Për këtë proporcionalitet të frikshëm, pra një masivitet kritik dhe padënueshmëri thuajse zeroja ka gjithmonë një koncept të gabuar, por jemi në nivelet më minimale, ndryshimet ligjore janë aty dhe duhet t'u paraprijnë. Në rast se ne nuk bëjmë dot shembuj stigmatizimi dhe dënimi shumë të rreptë të tyre, me mundësitë më të rrepta të ligjit, duke krijuar të gjitha lehtësirat procedurale, pasi ju keni një seri konstatimesh, të cilat për vështirësitë procedurale që kanë nuk merren parasysh, pra për çdo denoncim tuajin që nuk merret parasysh çdo fëmijë nuk është thjesht i dëmtuar, por është i rrezikuar të bëhet pjesë e një rrjeti kriminal...

Mirgjit Vataj – Ju siguroj, zoti Vasili, se vetëm nga *youtube* janë lëvizur të paktën 60 video, të cilat kanë krijuar një shqetësim të vazhdueshëm...

Petrit Vasili – Jam plotësisht dakord me ju...

Mirgjit Vataj - .. vetëm nga bashkëpunimi direkt që ne kemi dhe për asnjë nga personat që i ka ngarkuar këto video nuk është iniciuar hetim për të parë se kush ka qenë personi që i ka ngarkuar.

Petrit Vasili – Më lejoni t'ju them një gjë, ju e dini më mirë se unë, por për merak dhe kërshëri kemi ndjekur se çfarë ka bërë bota, të cilët kanë qenë shumë të rreptë me pjesën ligjore dhe legjislacionet e tyre kanë ecur me ato pjesët gri, edhe pse janë kritikuar për mosrespektimin e të drejtave të njeriut, por aty nuk kanë pyetur dhe e gjithë Europa është treguar shumë e rreptë, kurse ne e kemi këtë boshllëk. Pra, në rast se nuk e bëjmë këtë punë, të jeni të bindur se ndjeshmëria nuk do të japë rezultatet e duhura, në qoftë se nuk shohim ndëshkimin ekstrem, maksimal dhe shembullor. Në rast se mediet tona, sot në komision kemi shumë medie të pranishme, një rast pedofilie apo një rast dhune, apo një grabitqar seksual siç është quajtur e të tjera, në momentin që dënohet nuk e bëjnë objekt të një stigme publike shumë të rreptë dhe të egër, nuk kemi bërë asgjë fare.

Në rubrikat tona pasqyrohet dy javë rresht një kriminel që ka vrarë me sëpatë, del kur jepet gjyqi, masa, shkohet në familje dhe pyetet se si ka ndodhur, kthehen dhe ikin prapë,

ndërkohë që qindra dhe mijëra fëmijë janë nën një dhunë të gjithë formave. Ku janë fajtorët e dhunës? Ja, ju jeni ata që e hulumtoni dhe do të ishin shumë të lumtur të na reflektonit ne sot kaq e kaq raste të dënuara dhe të dërguara deri në fund, marrja e dënimit, por nuk i keni. Ju nuk i keni këto, pasi nuk është kuadri ligjor, sepse Kodi Penal te ne duhet të ishte më i lehti dhe më i thjeshtuari në botë. Të jeni të bindur se shembujt e mëdhenj të bërë publikë bëjnë punën e tonelatave të tëra promocion, pa shembuj, edhe prindërit nuk mbrohen dot, sepse mënyra se si atakohet nëpër rrjetet kompjuterike, edhe një prindërim i kujdesshëm mund të bëhet pjesë e saj. Pjesa edukative me pjesën praktike nuk janë në një garë të barabartë, *Youtube* ecën me një shpejtësi të madhe... Në qoftë se ai që bën një krim do të marrë një dënim të tmerrshëm dhe do t'i shkatërrohet jeta për atë që ka bërë, të jeni të bindur se disa e kanë për bindje, disa e kanë për frikë dhe ne nuk mund ta mohojmë këtë. Forca e ligjit edukon frikë dhe druajtje që ky veprim i rëndë kriminal... Ne para se të jemi deputetë dhe politikanë, në radhë të parë jemi prindër, disa nga ne për shkak të moshës jemi bërë gjyshër dhe këto ndjeshmëri duhet të na prijnë.

Unë jam plotësisht dakord me ju për ndryshimet në Kodin Penal, por edhe për ndryshime në ligje të tjera, që të gjitha lehtësimet që duhen bërë, edhe në kurriz të kanuneve që flasin për të drejtat e njeriut. Në këtë pikë ne duhet të jemi shumë të rreptë, pasi të dhënat që ju jepni dhe i keni bërë publike në media dhe në aktivitete të ndryshme, janë të tilla ku forca e ligjit, ndëshkueshmëria dhe fenomeni nuk janë në përputhshmëri të plotë. Fenomeni ecën me shpejtësi, ju bëni sakrificë të jashtëzakonshme që e evidentoni dhe nëpërmjet çdolloj ndërhyrjeje që bëhet ju shpëtoni shumë njerëz, por forca e shembullit na mungon. Kështu që, jo vetëm përmirësimi i Kodit, por edhe përmirësime të tjera të disa ligjeve të tjera që lidhen me të, duhen patjetër të jenë objekt urgjent, pasi me këtë kulturë pandëshkueshmërie rrezikojmë që fenomeni të bëhet absolutisht i pakontrollueshëm.

Po, zonja Spahiu.

Klodiana Spahiu- Së pari dua t'ju falënderoj!

Ne kemi pasur një bashkëpunim shumë të ngushtë me ju si komision, por edhe në nivel institucional, ku vazhdimisht ju keni sjellë ndryshime ligjore, po marr shembull ligjin për mbrojtjen e fëmijëve dhe të gjitha ndryshimet që janë bërë deri tani. Unë mendoj se problematika që ju ngrini është shumë e rëndësishme dhe nuk duhet pritur 1 qershor për këtë problematikë. Është e vërtetë që ndryshimet në Kodin Penal, siç e dini edhe ju, kërkojnë një numër të caktuar votash, të cilat ne si maxhorancë nuk i bëjmë dot vetëm. Unë ndjehem shumë mirë që sot kemi edhe një pjesë të deputetëve të opozitës, të cilët i mbështesin këto ndryshime ligjore, por do të ishte shumë mirë që kjo seancë dëgjimore të ishte bërë së bashku me

Komisionin e Ligjeve dhe me Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut. Ne do të jemi shtysë për t'u realizuar këto ndryshime, por përgjegjës janë ata.

Megjithatë, dua t'ju falënderoj edhe një herë për vendosmërinë tuaj për t'u përballur me këtë fenomen kaq të rëndë. Ashtu siç e tha edhe zoti Vasili, ne jemi në mosha të ndryshme, kemi fëmijë në shtëpi dhe shpeshherë jemi dëshmitarë të rasteve kur ruajmë fëmijët se mos shikojnë ndonjë gjë që nuk është e përshtatshme për moshën e tyre.

Lufta kundër krimit kibernetik është një sfidë e madhe, jo vetëm në mbrojtjen e fëmijëve, por në të gjitha fushat. Unë mendoj se ne nuk jemi në nivelin bashkëkohor në lidhje me luftën kundër krimit kibernetik, por, nëse do të ishte e nevojshme që të kërkohet mbështetja jonë në këtë fushë, ose siç e thatë edhe ju, që e bëni diku privatisht mënyrën për të hequr këto video, ndryshimet ligjore në Kodin Penal do të realizojnë një frenim akoma më të madh të numrit të shfaqjes së këtyre videove, filmimeve apo të gjitha mënyrave që përfshijnë përhapjen e krimit seksual nëpërmjet rrjeteve *online*. Ne jo vetëm që na keni pro por mendoj se jemi të vonuar. Sot kjo seancë dëgjimore u bë meqenëse është festa e 1 Qershorit, që me të drejtë nuk do të jetë festë, ju do ta bëni manifestim, dhe ashtu duhet të jetë. Kemi diskutuar plot çështje për fëmijët, duke filluar që nga kequshqyerja, arsimimi, por sot jemi në një stad më të avancuar. Po diskutojmë një problematikë shumë të rëndësishme, por duhet të jetë në fokus sot e tutje që të realizohen sa më parë këto ndryshime ligjore. Unë mendoj se jo vetëm kolegët e opozitës që janë sot, por edhe pjesa tjetër e saj, do të na bashkohen për të realizuar këto ndryshime në Kodin Penal.

Edhe një herë propozoj nëse është e mundur që ne ta realizojmë bashkërisht me ta, që të ideohen këto ndryshime në Kodin Penal dhe ndryshimi ndoshta në ligjin “Për mbrojtjen e fëmijëve”, sepse duhet të reflektohet edhe aty.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është paraprirë.

Gjithsesi ju falënderojmë!

Petrit Vasili - Po, zonja Spiropali.

Elisa Spiropali – Përsëritet të gjithëve!

Ju falënderoj për këtë prezantim, në të cilin në fakt për të gjithë ne që jemi prindër, por besoj për çdo njeri me një ndjeshmëri minimale, janë fakte të rënda, që duhet të adresohen me ligj, me fushata, me ndëshkim të rreptë dhe të gjitha me radhë!

Ju e keni më të qartë sesa ne, sepse punoni përditë në këtë fushë dhe mundoheni t'i mbronin fëmijët qoftë nga problematikat e ngacmimeve *online*, por edhe për raste të tjera, siç tha zoti Hazizaj, të ngacmimeve në dyert e gjimnazeve, që për fat të keq është dhe një pjesë e kulturës sonë. E mbaj mend që nga koha kur kemi qenë nëpër shkolla, është një

bulizëm i një lloji tjetër, i cili është rëndues psikologjikisht për vajzat, por edhe për djemtë që duan një jetë normale.

Për sa u përket ndryshimeve ligjore, nuk diskutohet, e tha kryetari dhe të gjithë këtu, edhe maxhoranca, ne jemi të gatshëm t'ju mbështesim. Ndoshta edhe një dëgjese e përbashkët me Komisionin e Ligjeve do të ishte shumë e frytshme. Pyetja ime është konkrete: a keni ju propozime për ndryshime në Kodin Penal, për ndryshime në ligje të tjera, për ndërhyrje tërësore, një paketë? A keni një model dhe ku e keni marrë atë, nëse do të zgjidhnim një vend apo një model që funksionon për sa i përket mbrojtjes së fëmijëve dhe ka avancim në kuadrin e ligjeve për mbrojtjen e fëmijëve? Teknologjia ka dalë edhe nga kontrolli dhe duhet që kontrolli mbi teknologjinë të jetë i tillë, i avancuar. Cilin model keni marrë? Nëse e keni të gatshme këtë paketë ndryshimesh, na e sillni që t'ju ndihmojmë për ta çuar përpara sa më shpejt.

Faleminderit!

Petrit Vasili - Faleminderit!

Po, zoti Pendavinji.

Ilir Pendavinji – Shumë mirë që po bëhen diskutime, por do të doja të dëgjonim të gjithë të ftuarit, sepse ne do të dinim të adresonim edhe më mirë, pasi kështu do ta marrim fjalën nga 2-3 herë dhe do të nisim të themi të njëjtat gjëra. T'i dëgjojmë të gjithë, sepse të gjithë kanë problematika rreth këtij fenomeni.

Petrit Vasili - Pa diskutim, që të gjithë të ftuarit do adresojnë, por problemi qëndron se meqenëse kishim disa gjëra konkrete, të cilat kishin interes të veçantë, qëndruam pak më gjatë. Atë që po diskutojmë tani, nuk do ta diskutojmë në fund. Pra, jemi brenda të njëjtës procedurë.

Lidhur me sugjerimin e fundit, zoti Hazizaj unë do të thosha të ishim konkretë. Ne mirëpresim sa më parë që të jetë e mundur propozimet konkrete. Nuk besoj se shërben ndonjë gjë të veçantë, që të bëjmë seanca dëgjimore të përbashkëta, pasi në këtë komision lindën këto shqetësime, ne të gjithë së bashku mund t'i adresojmë ato dhe mund t'i përcjellim si një nismë e përbashkët e deputetëve. Komisioni i Ligjeve është një komision, i cili bën shqyrtimin juridik, ai nuk është as vendimmarrës, as imponues. Madje në këto çështje Komisioni i Ligjeve ka qenë i vonuar, ai i ka pasur këto në tavolinë. Zoti Hazizaj nuk i ngre këto probleme për herë të parë. Komisioni i Ligjeve në disa raste është treguar shumë *rixhid* për këtë punë, ndërkohë që duhet të ishte shumë fleksibël. Ne kemi përforcuar dënimet, shumë mirë kemi bërë, sepse lidheshin me aksidentet në rrugë, por kjo është shumë më e rëndë. Kjo është një veprimtari kriminale e strukturuar. Një aksident në rrugë ndodh edhe nga pakujdesia, ka motive shumë më të pafajshme sesa këto që janë të një faji të qartë dhe identik.

Pra, zoti Hazizaj, ky është një vullnet i përbashkët i të gjithëve ne. Jemi shumë të motivuar. Në këtë rast ka rënë politika. Këtu bëhet fjalë për fëmijët tanë në radhë të parë. Kjo është dita e një rimarrjeje në mënyrë shumë aktive të kësaj pune. Unë jam shpresëmadh si të gjithë kolegët këtu që në 1 Qershorin tjetër, të paktën për këtë çështje nuk do të diskutojmë, por do të diskutojmë për disa çështje të tjera. Kjo punë nuk do të shterojë menjëherë, por jam i bindur se pas 1 Qershorit të vitit që vjen, do të kemi disa instrumente të tjerë shumë më të fortë. Shpresoj të kemi një raportim për shumë persona të ndëshkuar për shkak të tyre.

Kalojmë te zonja Ervjola Osmanaj. Edhe për ju zonja Osmanaj është e njëjta ftesë, të jemi sa më sintetikë.

Ervjola Osmanaj - Po, do të jem shumë koncize.

Petrit Vasili – Nuk duhet të ma keqkuptoni ftesën.

Ervjola Osmanaj – Jo, absolutisht!

Përshëndetje, i nderuar zoti Vasili!

Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit!

Në radhë të parë më lejoni t'ju falënderoj përzemërsisht për ftesën që i keni bërë Rrjetit Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri për t'iu bashkuar seancës së sotme dëgjimore. Ne si rrjet kombëtar kemi organizata, të cilat punojnë jo vetëm me fëmijët dhe të rinjtë, por kemi organizata që punojnë vazhdimisht me gratë, me vajzat e reja të dhunuara. Këtu përfshijmë dhunën fizike, seksuale por edhe çdo lloj forme tjetër të dhunës. Referuar disa të dhënave zyrtare nga institucione si: Policia e Shtetit apo Avokati i Popullit gjatë vitit 2017 rezulton se janë rreth 4 mijë raste të dhunës me bazë gjinore të regjistruara në Policinë e Shtetit, 2539 vajza të reja dhe gra kanë kërkuar urdhër mbrojtjeje për shkak të dhunës nga të afërmit e tyre apo edhe për shkak të përndjekjes së personave të ndryshëm në rrjetet sociale. Ne kemi këto shifra të deklaruara, por mendoni sesa vajza të reja apo gra nuk kanë deklaruar dhunën që ushtrohet ndaj tyre, qoftë kjo nga frika e agresorit apo qoftë nga pasiguria që ndiejnë se çfarë do të ndodhë me jetën e tyre në rast se ato do ta bëjnë këtë denoncim.

Referuar kësaj situatë shqetësimi ynë është se organet përkatëse nuk marrin masat e duhura lidhur me ushtruesit e dhunës, duke përfshirë edhe përndjekjen në rrjetet sociale. Për rrjedhojë ne kemi raste të përsëritura dhune që mund të shkojnë deri në vrasje. Ka një mungesë të theksuar të shërbimeve sociale dhe mbrojtëse për vajzat dhe gratë e dhunuara.

Së fundi, ne ndajmë të njëjtin shqetësim që ndau pak më parë Altini, i cili ka të bëjë me vjedhjen e identitetit. Gjatë punës sonë me adoleshentët në shkolla na kanë referuar raste kur janë vjedhur adresat e *facebook*-ut, të *instagram*-it, fotot e tyre janë shpërndarë, janë bërë shpërndarje të videove abuzuese, videove të papërshtatshme, duke i ekspozuar të rinjtë

adoleshentë në shkollë çdo ditë dhe më shumë ndaj fenomenit tejet shqetësues, siç është bulizmi.

Në këtë kuadër është shumë e nevojshme që Kuvendi të angazhohet, siç u tha, që ndryshimet në Kodin Penal të përfshijnë të gjitha veprat penale që cenojnë sigurinë e fëmijëve në internet. Është e nevojshme të kemi një shtim të ofrimeve të shërbimeve sociale mbrojtëse dhe rehabilituese për vajzat dhe gratë e dhunuara, si edhe këto shërbime të financohen në mënyrë që të jenë sa më të qëndrueshme.

Për ta mbyllur fjalën time, ne si Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri mbështesim sugjerimet dhe problematikat e ngritura nga CRCA-ja dhe Alo 116. Sigurisht, jemi mbështetës të çdo nisme apo iniciative që do të ndërmerret në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve adoleshentë në internet.

Faleminderit!

Petrit Vasili - Faleminderit, zonja Osmanaj!

Zonja Rezarta Gjalpi, përfaqësuese e shoqatës “Fëmijët sot” dhe “Rrjetit për të Drejtat e Fëmijëve”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Ka një ndërhyrje nga kolegia, zonja Kërpaçi.

Floida Kërpaçi - E mora fjalën për të falënderuar të gjithë kolegët që kanë ardhur sot në këtë komision, jo vetëm për sot dhe për këto studime, por për të gjithë bashkëpunimin që kemi pasur gjatë gjithë kësaj kohe, duke ngritur çështje mjaft sensitive, por edhe duke gjetur zgjidhje dhe duke ngritur zërin për to!

Dua të marr shkas nga fjala e Eryjolës për rastin e grave dhe të vajzave, të cilat kanë kërkuar mbrojtje. Në fakt, është një çështje shumë sensitive, sepse sot nuk kemi një statistikë zyrtare sesa gra dhe vajza janë të dhunuara për një arsye. Mendoj se është shumë e qartë, ka ardhur edhe nga vetë gratë dhe vajzat, pasi nuk ndejnë asnjë lloj garancie nga shteti, nga ligji, se në momentin që ato do të raportojnë rastin e tyre do të jenë të mbrojtura. Të gjendura në këtë situatë kemi dëgjuar mjaft raste që pasi janë raportuar, kemi parë raste vetëvrasje apo edhe raste të grave dhe vajzave të vrara. Në këtë situatë alarmante pa diskutim që vëmendja jonë duhet të rishkojë edhe një herë në rikthimin se çfarë mund të bëjmë, si mund të ndërhyjmë në legjislacion për t’u siguruar këtyre vajzave dhe grave të dhunuara një garanci më të madhe që në momentin që ato raportojnë një situatë dhune në familje por jo vetëm, shteti të garantojë siguri dhe t’u japë atyre të gjithë mbështetjen ligjore.

Për sa u përket të rinjve dhe sigurisë së tyre në internet, unë ndaj të njëjtin mendim me kolegët edhe për propozimet që ndau deputetja Malaj, duhet të mendojmë një strategji më të

mirë. Ndoshta, zoti zëvendësministër mund të na japë edhe një raportim të shifrave: çfarë shifrash kanë të mbledhura për këto raste, çfarë mekanizmesh kanë përdorur për mbrojtjen e këtyre të rinjve për sa i përket përdorimit të rrjeteve *online*, a kanë qenë efikase? A i kanë parë të rinjtë këta mekanizma si një mjet mbrojtës për ta apo me sa po shikojmë nga shifrat vazhdojnë të jenë shifra alarmante dhe mesa duket mekanizmat që mund të jenë përdorur nuk kanë qenë më të duhurit? A ka pasur nga ana juaj një lloj monitorimi, vlerësimi sesi ka qenë strategjia deri më sot? Çfarë është bërë? Si do të vazhdojmë në ditët dhe vitet në vazhdim, në mënyrë që 1 Qershorin e ardhshëm të kemi mundësi të implementojmë politika, iniciativa ligjore që të përmirësojnë situatën dhe t'u japin siguri të rinjve fëmijëve dhe familjeve.

Faleminderit!

Petrit Vasili - Faleminderit, zonja Kërpaçi!

Po, zonja Gjapli.

Rezarta Gjalpi - Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam listuar një sërë problematikash, por do të jem sa më koncize me to. Referuar kolegëve, të cilët përmendën problematikën: siguria *online*, unë do të ndalesha në një problematikë shumë të rëndësishme në përgjithësi në situatën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijëve në vend, kryesisht referuar nga puna jonë në terren, e cila është e përditshme dhe ka në fokus shkollën si njësi kyçe me të cilën ne punojmë.

Më duhet ta nis nga ajo se çfarë është e dukshme në shkollat tona. Problematika vazhdon të qëndrojë, ka mungesë të theksuar të infrastrukturës së përshtatshme fizike në shkollat publike dhe është tejet e evidente. Do ta nis me disa nga elementet se çfarë mungon realisht në këto shkolla. Mungojnë tualetet, kushte të papërshtatshme higjieno-sanitare, mungon uji, mungojnë terrenet sportive. Përgjithësisht qytetet e vogla, nuk po marrim Tiranën, por në përgjithësi kanë një jetë shumë të varfër social-kulturore, ka mungesë të terreneve sportive ndonjëherë edhe pse telefoni, rrjetet sociale janë kaq shumë të bujshme. Në këto ditë që flasim në shumë shkolla publike, kryesisht në qendrat e qyteteve ka një numër shumë të lartë të nxënësve krahasuar me numrin e mësuesve. Ky është një problem i dukshëm. Pa u ndalur në se çfarë ka në funksion shkolla, këto janë gjëra evidente dhe që patjetër duhet të minimizohen.

Nga puna në terren konstatojmë se shkolla ka një mungesë të theksuar, pra shkollat në përgjithësi ngurrojnë të marrin iniciativa, të jenë partnere, të jenë ideatore në projekte të ndryshme, ku vetë shkolla duhet të fuqizohet për ta luajtur rolin e saj shumë mirë dhe besoj se mund ta bëjë këtë gjë shumë mirë.

Në fakt, unë do t'u referohem disa të dhënave që ne kemi lidhur me një studim që kemi bërë dhe një program dyvjeçar që mbyllëm për sa i përket dhunës ndaj fëmijëve në

shkolla në Shqipëri, kryesisht të raportuara nga fëmijët, vazhdon të qëndrojë si problematikë dhuna psikologjike. Raportohen në shkolla ku forma e bërëtur nga mësuesit është shumë e shpeshtë, ku 40% e nxënësve e përjetojnë këtë formë dhune në shumë frekuenca ditore. Pason forma të tjera të dhunës, duke filluar me epitete fyese, rreth 16% e nxënësve shprehen se e kanë përjetuar këtë formë dhune shumë shpesh. Kur flasim për epitete fyese shpeshherë përdorimi i nofkave vazhdon të jetë prezent nga mësuesit. Nuk lihet pas dore edhe dhuna fizike në shkolla, ajo është prezente rreth 12% e nxënësve kanë përjetuar këtë dhunë fizike, kryesisht janë djemtë më tepër. Vazhdon të qëndrojë shqetësuese ndër format e dhunës, kërcënimi me notë. Pra, si formë e dhunës psikologjike, rreth 22 % e nxënësve shprehen se janë kërcënuar. Pra, kërcënohen nga mësuesit në lidhje me këtë formë.

Do të doja të ndalesha pak te pjesa e studimit dhe tek abuzimi. Në fakt, kjo është diçka që vazhdon të mbetet problematike në shkollat tona. Në fakt, këtë e kemi konstatuar jo vetëm nga studimet tona, por edhe nga puna jonë disavjeçare me nxënës, me mësues, me prindër. Pra, bazohem jo vetëm te studimet, por edhe te puna konkrete që ne kemi bërë, te ndërhyrja konkrete në shkollë, Vazhdon të evidentohet si nevojë emergjente informimi dhe në ndërgjegjësimi në lidhje me identifikimin e hershëm të abuzimit të fëmijët. Kryesisht, fokusin do ta vija te komuniteti i prindërve.

Në fakt, këtu u cek pak, por edhe zonja Malaj e përmendi pjesën e prindërve si përfshirës në shkollë, ka një mungesë të theksuar të informacionit e të orientimit, për të adresuar problematikat, nevojat e shqetësimit të fëmijëve, qoftë në kuadër të një abuzimi që mund t'i ketë ndodhur fëmijës apo çdo lloj problematike a shqetësimi tjetër.

Mbetet shumë problem pjesa e raportimit. Vazhdon fenomeni i mbajtjes tabu. Pra, në shkollat tona e konstatojmë dhe e vërtetojmë shumë herë, se çdo gjë që flitet qëndron aty. Është shumë e vështirë të ndash eksperiencat, ndjesitë, apo për ta raportuar një problematikë e një shqetësim. Kjo vlen si për mësuesit në shkollë, ashtu edhe për prindërit. Në fakt, kam shumë argumente në lidhje me këtë pjesë, por gjithsesi po kaloj në një çështje shumë të rëndësishme: strukturat e shkollës.

Ne flasim këtu për politika, flasim për ligje, flasim për udhëzues e shumë gjëra të tjera. të gjitha i kemi shumë të mira. Në qoftë se ndalemi në shkollë, po të marrim të gjitha ligjet, strukturat e standardet, ejani t'i përkthejmë e t'i vëmë në praktikë.

Jo vetëm institucionet qeveritare i kanë shumë të mira, por edhe ndihma që ka dhënë gjatë gjithë kohës shoqëria civile për të përmirësuar jo vetëm ligjet, politikat, standardet, komisionet e etikës e të disiplinës, të gjitha janë funksionale në ligje, por ejani t'i përkthejmë ato në praktikë. Pra, vazhdojnë të qëndrojnë inekzistente bordet e prindërve, qeveria e nxënësve, pjesëmarrja e fëmijëve. Ne flasim gjithë kohës, por këto vazhdojnë të jenë inekzistente. Ne

punojmë me fëmijët nëpër aktivitete, ndërhyjmë në shkollë, por fëmija nuk e di se është pjesë e një qeverie nxënësish, që ka të drejtë t'i dëgjohet zëri, dhe i vetmi rast kur mund t'i dëgjohet zëri fëmijës, është kur merr pjesë në një ekskursion. Për vendimmarrje të tjera kjo gjë është inekzistente.

Edhe shërbimi psikosocial, që do ta veçoja pak, është shumë problem në shkollë. Psikologu vazhdon të mos e gëzojë legjitimitetin e tij dhe besueshmërinë te fëmijët, por edhe te aktorët e tjerë, që janë në shkollë: drejtuesit apo instancat e tjera.

Ato çfarë unë do të rekomandoja, janë dy gjëra kryesore, që të mos ndalem shumë gjatë. Patjetër partneritete të fragmentuara. Shpesh herë ka raste kur evidentohen përtej shkollës, por nuk gjendet. Pra, ne jemi në pozicionin që e identifikojmë rastin e dhunës e të abuzimit, por mbetemi aty. Se çfarë bëhet më tej, se si mund të menaxhohet ky rast, diskutojmë rreth kësaj gjëje.

Ajo çfarë do të sjellim si rekomandim kryesor nga Ministria e Arsimit, por edhe nga ministritë e linjës, sepse flasim gjithë kohës për këtë pjesë, është patjetër monitorimi. Pra, monitorimi i sistemit të të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së tyre. Po të shkosh në shkollat shqiptare, vëren se ato nuk monitorohen as nga nivelet e tyre DARZA, as në nivel qendror, në lidhje me situatën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijëve në vend. Nga ana tjetër, vetë shkollat nuk e kanë këtë autonomi për ta ngritur zërin, kështu që vazhdojmë të mbetemi në një handicap shumë të madh. Ne e kemi ngritur disa herë në seanca dëgjimore, se është shumë e rëndësishme politika e mbrojtjes së fëmijëve. Ka ardhur koha që çdo shkollë të ketë politikën e mbrojtjes së fëmijëve. Mbase ky do të jetë një rregullator shumë i mirë për të gjitha instancat që ndodhen brenda shkollës, por edhe jashtë saj, me synimin për të punuar më mirë në lidhje me të drejtat e fëmijëve.

Në fakt, kisha edhe shumë gjëra të tjera, por i rashë pak shkurt.

Petrit Vasili – Më fal, ju thatë në fund, që ta lidhim një çikë atë që thatë, me mekanizëm mbrojtës brenda shkollës, me aktivizim institucionesh, me rregullat shumë të mira që ka shkolla. Më vjen keq, por ju dhatë një shifër, e cila është një shifër, e cila të gjithë këto mekanizma, për atë që e njeh funksionimin e shkollës, i rrëzon që të gjitha. Ju thatë: njëzet e ca, njëzet e tre për qind a njëzet e tete për qind e nxënësve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, më fal!

Kërcënohen me notë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Njëzet e ca për qind? Sa thatë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ishin me notë? Dymbëdhjetë për qind.

Tani, në një sistem arsimor, 12 % kërcënohen nga mësuesit? Kush na e garanton këtë? këta që janë kërcënues? A mund të përfytyrojmë se ekziston kërcënimi me notë? Pa i dhënë përgjigje kësaj, nuk mund t'i mbrojmë nga ata që i kërcënojnë. Kjo është një nga të dhënat më tronditëse, që mund të ekzistojnë. A mund të përfytyroni ju këtu, që fëmijën tuaj mund ta kërcënojë me notë një mësues apo mësuese, kushdo qoftë? Ktheheni dot në fëmijërinë tuaj për të kujtuar se kush ju ka bërë shantazh apo ju ka kërcënuar me notë? E keni urryer si figurë. Është shifër shumë e lartë kjo. Unë do të thosha të qëndrojmë te kjo shifër, sepse thelbi i funksionimit të një sistemi është raporti i atyre që kanë detyrën e mësimdhënies kundrejt atyre që marrin mësim. Sepse nuk janë thjesht mësues, por në radhë të parë janë edukatorë. Edukatori që edukon me shantazh nuk mund të jetë aleati ynë.

Pa qëndruar te kjo çështje, pa e zbërthyer, pa e analizuar, pa i shkuar deri në fund, të jeni të bindur, e po jua them në mënyrë shumë të drejtpërdrejt, mos kini shpresë se mund të funksionojnë mekanizmat e tjerë. Jua them prapë: ai që kërcënon e shantazhon nuk mund të jetë aleati i kurrkujt në mbrojtjen e të drejtave, sepse ka psikologjinë e shantazhit. Për më tepër, ai është shantazhuesi më i shëmtuar që mund të ekzistojë, sepse shantazhon fëmijët. Ndërmjet adultësh kjo është e papranueshme, por ata kanë të tjera mekanizma integriteti psikologjik, psikosocial e të tjera, por të shantazhosh me notë në vitin 2018, sinqerisht, me thënë të drejtën, kjo më lë pa gojë. Që mësuesi mund të gabojë në vlerësim, kjo është humane. Absolutisht! Edhe ne që kemi dhënë mësim, objekte të gabimit jemi, por të shantazhojmë: po s'e bërë këtë, unë do të vë këtë notë?! Kësaj i thonë ta vrasësh një fëmijë. I ke lënë një shenjë, e ke mbushur me urrejtje, e ke bërë të kuptojë se shkolla – thoshin gjithmonë se shkolla, kisha e xhamia janë vende të paprekshme edhe në kohë luftërash – shantazhon. Po si mund të ndodhë kjo? Kësisoj, në këtë pikë, do të thosha se është fjala për një çështje, e cila, nëse nuk adresohet, të tëra reformat janë zero. Absolutisht! Përpara një figure, e cila ka tridhjetë fëmijë, dyzet fëmijë në një orë mësimi, ndërsa gjatë gjithë ditës mund të kontaktojë me njëqind e pesëdhjetë fëmijë në pesë a gjashtë klasa të ndryshme... Sepse duhet të dini një gjë: ai ka shantazhuar një fëmijë, por këtë e kanë marrë vesh plot të tjerë. Edhe të tjerët janë ndjerë të shantazhuar: që duhet ruajtur nga ky mësues, se të kërcënon. Apo mësuese, kushdo që të jetë, se s'ka rëndësi gjinia e tyre. Në këtë pikë them se mosadresimi i kësaj çështjeje do t'i bëjë të pamundura e do t'i zerojë të gjitha dëshirat e mira që mund të kemi ne për ta pasur shkollën aleaten tonë më të madhe, e që shkolla të na ndihmojë për t'u ruajtur nga ata kërcënuesit e tjerë, të cilët mund të jenë seksualë apo të të gjitha formave të tjera.

Megjithatë, faleminderit shumë për fjalën tuaj.

A ka ndonjë ndërhyrje nga Ministria e Shëndetësisë, para se ta kalojmë fjalën te Ministria e Arsimit?

Po. Me mikrofon, të lutem!

Ilsa Dede – Për sa i përket çështjes për të cilën jemi mbledhur sot, unë jam specialiste për çështjet sociale, pranë sektorit të barazisë gjinore. Doja të sillja në vëmendje disa dokumente shumë të rëndësishme, që janë ndërmarrë në kuadër të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, ashtu siç e theksuan edhe përfaqësuesit e grupit të interesit, që është ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, e njëkohësisht “Agjenda Kombëtare Për të Drejtat e Fëmijëve”.

Unë doja të theksoja se “Agjenda Kombëtare Për të Drejtat e Fëmijëve”, e cila është miratuar vitin e kaluar, ka si vizion kryesor krijimin e kushteve për sa i përket zhvillimit të shëndetshëm psikosocial të fëmijëve, duke u bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

Në këtë kuadër të axhendës janë ndërmarrë një sërë objektivash. Një nga objektivat më të rëndësishëm që ka kjo axhendë është përmirësimi i aksesit të shërbimit për mbrojtjen e fëmijëve, ku përfshihet edhe mbrojtja e fëmijëve në mjedisin dixhital e elektronik.

Paralel me “Agjenda Kombëtare Për të Drejtat e Fëmijëve”, një nga dokumentet shumë të rëndësishëm që u nënshkruan, është edhe “Plani i veprimit për sigurinë online të fëmijëve”. Ky plan veprimi ka parashtruar një sërë objektivash shumë të rëndësishme për sa i përket mbrojtjes së fëmijëve në mjedisin dixhital dhe elektronik.

Hartimi i këtij plani është bërë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Ministria e Brendshme, por ka pasur një rol shumë të rëndësishëm edhe CRCA-ja, e njëkohësisht edhe ACES-i, Autoriteti Kombëtar i Certifikimit Elektronik dhe i Sigurisë Kibernetike.

Dua të theksoj se ky plan veprimi ka masa konkrete, të cilat do të ndërmerren dhe do të angazhohen jo vetëm nga institucioni ynë, pra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka masa konkrete të cilat do të përfshihen edhe institucionet e tjera të linjës, të cilat e kanë nënshkruar këtë plan veprimi. Kuptohet, ky plan veprimi do të jetë ashtu siç është konsultuar me të gjitha grupet e interesit, ndaj këto masa e këto angazhime do t’i ndërmarrim së bashku.

Janë katër objektiva kryesore shumë të rëndësishme, që ka ky plan veprimi, ku përfshihen: rritja e sigurisë së fëmijëve në internet nëpërmjet përforcimit të kapaciteteve kombëtare e lokale, përforcimi i kuadrit ligjor, politika për sigurinë online të fëmijëve, forcimi i partneritetit ndërmjet institucioneve, organizatave qeveritare dhe industrisë për sigurinë e fëmijëve në internet, njëkohësisht ndërgjegjësimi dhe informimi për sigurinë online të fëmijëve.

Ky plan veprimi do të ecë paralel me “Agjendën Kombëtare Për të Drejtat e Fëmijëve”. Siç thamë, gjatë viteve, deri në vitin 2020, do të ketë aktivitete të shumta, të cilat do të synojnë mbrojtjen e fëmijëve për të mundësuar sigurinë online.

Është një dokument shumë i rëndësishëm, që e theksova në fillim, që është “Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”, ku është një nen posaçërisht i veçantë lidhur me sigurinë online të fëmijëve. Për të mos u zgjatur shumë, do t’ia lë fjalën koleges, e cila do të shpjegojë më me hollësi se çfarë është ky nen, dhe konkretisht çfarë po bëhet për sa i përket kuadrit të hartimit të akteve nënligjore sa i takon kësaj fushe.

Petrit Vasili – Faleminderit! Fjala për ju. Ju lutem, në mënyrë të përmbledhur.

Kleopatra Gjika – Shumë shkurt.

Faleminderit, zoti kryetar i komisionit!

Siç e theksoi edhe kolegia Ilsa, viti 2017 shënon një arritje shumë të rëndësishme për sa i përket sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Kemi miratimin e ligjit të ri “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, ligj i cili jo vetëm afirmon të drejtat e fëmijëve, por po ashtu siguron e garanton mbrojtjen e tyre. Në këtë këndvështrim mendoj se jemi munduar ta adresojmë problematikën e sigurisë online të fëmijëve, duke u garantuar fëmijëve një mbrojtje nga të gjitha format e dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, në të gjitha vendet ku konstatohet dhe kryhet kjo dhunë, përfshirë këtu dhunën dhe abuzimin online.

Një arritje shumë e rëndësishme është parashikimi i një neni të posaçëm për sa i përket mbrojtjes së fëmijëve nga materialet me përmbajtje të dëmshme e të paligjshme, që qarkullojnë në internet.

Jemi munduar të bëjmë një përkufizim se çfarë janë këto materiale të dëmshme. Këtu përfshihet të gjitha materialet, imazhet, pamjet, fotografitë, të cilat cenojnë dinjitetin e fëmijës. Kemi vendosur një detyrim për të gjithë ofruesit e shërbimeve të internetit, për të gjitha institucionet e edukimit, qoftë publike apo private, të cilat ofrojnë akses në internet për fëmijët, që të marrin masa për të aplikuar instrumente teknike e për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve nga këto materiale me përmbajtje të dëmshme a të paligjshme, që qarkullojnë në internet.

Ne kemi një marrëveshje me organizatën “Alo 116”, në të cilën, nëpërmjet portalit të sigurtë .al ata marrin referime edhe nga vetë fëmijët për rastet kur janë konstatuar dhunë ose abuzim online. Sigurisht, rastet raportohen te njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, të cilat i kemi në çdo bashki a njësi administrative. Jo vetëm kaq, por në momentin kur agjencia konstaton se në internet qarkullojnë materiale të paligjshme ose me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, në bazë të ligjit “Për sigurinë kibernetike”, njofton autoritetin përgjegjës për mbylljen e këtyre faqeve.

Gjithashtu, në zbatim të këtij ligji, jemi duke draftuar edhe një draft VKM, i cili si objekt ka të gjitha masat që mund të merren për të mbrojtur fëmijët nga këto përmbajtje të

dëmshme dhe të paligjshme që qarkullojnë në internet. Jemi ende në proces draftimi, por besoj se shumë shpejt do ta kemi të miratuar draft VKM-në.

Faleminderit!

Petrit Vasili - Zoti Kolgega, fjala për ju.

Shpati Kolgega – Faleminderit!

Dua të falënderoj kolegët, sidomos shoqërinë civile për parashtrimin e të gjitha çështjeve dhe problematikave. Mendoj se në këtë moment ku ne ndodhemi, teknologjia ecën më shpejt se ne, se ligjet dhe se ministria, prandaj ne duhet ta vendosim në fokusin tonë të gjithë këtë çështje, sepse në rast se nuk e vendosim në fokus dhe e lëmë në një cep, këtu flas për të gjithë ne, edhe si shoqëri civile, edhe si ekzekutiv, por edhe si parlament, atëherë do të jetë e vështirë që këtë problematikë ta zgjidhim dhe ta vëmë në vijë pjesën e zgjidhjes. Besoj se kjo çështje ka nevojë për një koordinim shumë më të mirë institucional edhe me shoqërinë civile për të adresuar të gjitha çështjet. Sigurisht që Ministria e Arsimit është shumë e ndërgjegjësuar për të gjitha këto probleme, të cilat ndodhin jo vetëm në shkolla, por në përgjithësi në shoqërinë tonë. Ajo që dua të them është se përtej të gjitha problemeve, duket sikur nuk ka asnjë monitorim ose një përkujdesje, të paktën për pjesën e arsimit sa u përket shkollave.

Më lejoni të them se ka disa nisma, për të mos thënë shumë nisma nga Ministria e Arsimit, të cilat, për fat të keq, nuk u përmenden qoftë nga kolegët deputetë, qoftë nga shoqëria civile, që besoj se i dinë shumë mirë.

Unë dua të përmend vetëm disa pika, sepse duhet të kishte një raportim shumë më të plotë për të gjithë situatën në shkolla. Të gjitha problemet që u ngritën këtu, pa dyshim që do të shkojnë menjëherë në Ministrinë e Arsimit.

Një nga reformat që është ndërmarrë këtë vit është shkolla si qendër komunitare. Pra, qasja ndaj këtyre problemeve, por jo vetëm, sigurisht që mund të bëhet nëpërmjet ligjit, nëpërmjet policisë, ndjekjes penale dhe ndryshimeve ligjore, por ajo që ne bëjmë është zgjidhja e problemeve nëpërmjet edukimit. Nëpërmjet kësaj nisme, sot kemi rreth 250 shkolla si qendra komunitare, të cilat kanë një metodologji të punuari shumë të avancuar, ndryshe nga shumë shkolla të tjera. Qëllimi i këtyre shkollave është që mësuesit të jenë sa më afër me nxënësit dhe me prindërit, pra të funksionojë si një komunitet. I gjithë procesi i vendimmarrjes në shkolla, që nga planifikimi i orëve të mësimi apo planeve mësimore, deri teki organizimi i aktiviteteve jashtëshkollore apo brenda në shkollë, të bëhet në komunitet. E gjithë shkolla përdoret nga komuniteti për organizim aktiviteteve, mbledhjesh, takimesh dhe konsultimesh të të gjithë aktorëve. Unë mendoj se kjo është një nismë shumë e mirë, që adreson këtë problem dhe besoj se edhe në shumë takime që bëhen në kuadër të këtij projekti të adresohen edhe çështje të tilla.

Kjo është një reformë që sapo ka nisur, pra janë projekte pilot, që ne tentojmë t'i shtrijmë në çdo shkollë, megjithëse që ky projekt të zbatohet në shumë shkolla, ka ende nevojë për infrastrukturë.

Një tjetër reformë ka të bëjë me mësuesit ndihmës. Besoj se përfaqësuesit e shoqërisë civile e dinë që për herë të parë janë futur mësuesit ndihmës nëpër shkolla, mësues që kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara. Unë mund ta them me bindje, madje i kam parë edhe vetë mësuesit, që u shërbejnë edhe fëmijëve, të cilët nuk kanë mundësi ose nuk kanë pasur mundësi të shkojnë në shkollë dhe kam parë që ka mësues, që shkojnë nëpër shtëpitë e tyre, pra u shërbejnë fëmijëve të caktuar në shtëpi, për të marrë mësimet dhe për të qenë më afër me shkollën dhe me komunitetin.

Mendoj se është një nismë shumë e mirë, që nuk është e mjaftueshme, absolutisht, sepse në radhë të parë ka nevojë që këta mësues të trajnohen. Mund të them se grupi i parë i tyre ka hyrë në trajnim dhe ka përfunduar për herë të parë trajnimin për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Ndërkohë, këtë vit, ne do të shtojmë edhe 300 mësues të tjerë ndihmës, që do të jenë në shkollat tona dhe në total numri (mendoj se jam preciz në këtë pjesë) do të jetë 585. Mendoj se është një gjë që duhet thënë, pra është një moment që ka ndryshuar shumëçka në raport me fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo nuk siguron vetëm pjesën e ndihmës ndaj tyre, por siguron edhe motivimin e prindërve, që t'i sjellin këta fëmijë në shkolla, sepse ekziston fenomeni që këta fëmijë fshihen nga prindërit e tyre, prindërit i mbajnë në shtëpi këta fëmijë dhe një pjesë e tyre nuk e pranon që këta fëmijë janë me aftësi të kufizuara apo kanë probleme të ndryshme. Kështu që këta mësues dhe shkollat në përgjithësi, i nxisin fëmijët të vijnë në shkolla dhe të bëhen pjesë e komunitetit.

Një tjetër gjë që doja të thosha, ka të bëjë me psikologët. Sigurisht, ka akoma shumë punë për të bërë nga psikologët në shkolla. Raporti aktualisht është 1 psikolog për 1300-1400 nxënës. Këtë vit ne do të dyfishojmë numrin e psikologëve nëpër shkolla, në mënyrë që raporti të jetë më i pranueshëm dhe të shkojë në raportin 1 psikolog për 700-800 nxënës, në varësi të shkollave, sepse duhet të kuptojmë që shkollat kanë edhe largësi të mëdha gjeografike, kur bëhet fjalë për zona të shtrira apo zona të thella rurale.

Një tjetër gjë, që është bërë për herë të parë këtë vit, ka të bëjë me planet e punës që janë hartuar dhe miratuar edhe nga prindërit, pra pjesëmarrja direkte e prindërve në gjithë procesin mësimor, në gjithë procesin e vendimmarrjes së mësuesve dhe nxënësve.

Mendoj se është vetëm fillimi i procesit për t'i afruar nxënësit, prindërit dhe mësuesit në një komunitet.

E fundit (dhe dua ta mbyll) ka të bëjë me oficerët e sigurisë nëpër shkolla.

Ne kemi filluar një projekt pilot, që po ndodh aktualisht në 16 shkolla të Tiranës, ku janë marrë të rinj nga Shkolla e Policisë, të cilët janë trajnuar nga Ministria e Arsimit për të qenë në shkolla dhe, këta oficerë, le të themi, janë mbrojtësit e fëmijëve nëpër shkolla, janë njerëzit e tyre më të afërt, të cilët janë gjatë gjithë kohës vigjilentë, janë gjatë gjithë kohës në komunikim me nxënësit, me mësuesit dhe me prindërit. Besoj se është një projekt, i cili në vazhdim do të shtrihet edhe në shkolla të tjera të Shqipërisë.

Të gjitha këto nisma i përmenda jo pa qëllim, por për të thënë se ka një reagim shumë të fortë nga Ministria e Arsimit për pjesën e edukimit për këto çështje.

Të gjitha problemet që u shtruan, sigurisht, kanë nevojë për një mbështetje shumë të madhe ligjore. Ka një nevojë të madhe që të ketë ndoshta edhe më shumë buxhet. Kjo mund të jetë një çështje që mund të shtrohet edhe në qeveri, ndoshta edhe në parlament, për t'i dhënë një fuqi më të madhe, sepse, sigurisht, gjithë këto gjëra që po bëhen...

Ne do të donim shumë të kishim mësues ndihmës për çdo nxënë. Do të donim shumë të kishim psikologë në çdo shkollë. Megjithatë, këto gjëra kanë nevojë për një shtytje akoma më të madhe, në mënyrë që vitet në vazhdim të kemi një qasje akoma më të mirë. Qasja është shumë e gatshme. Ne jemi shumë të gatshëm për të bashkëpunuar me të gjitha institucionet. Besoj se fakti që ky diskutim është ngritur në këtë nivel, është shumë mirë. Mbështetja jonë do të jetë shumë e madhe, për të bashkëpunuar dhe për ta shtyrë përpara gjithë procesin.

Faleminderit shumë!

Presim rekomandime dhe sugjerimet, qoftë edhe në vetë, si ministri, si institucion.

Petrit Vasili – Faleminderit!

Kam dy gjëra për të thënë, një konstatim të vjetër dhe një të ri.

Po rimarr (meqë ju jeni prezentë) të njëjtin konstatim, të cilin ia kam bërë me dije edhe kohë më parë Kryeministrit të vendit, që ka lidhje në mënyrë të drejtpërdrejtë me ngarkesën mësimore të fëmijëve në shkolla.

I dashur zoti zëvendësministër,

Për të gjitha ato që referuat, nuk kam asnjë koment negativ dhe të gjitha janë të mirëpritura, por duhet të dini një gjë: nuk monitorohet dot nga ju se ç'ndodh realisht në shkolla.

Në rast se do të bënim një analizë didaktike, të mirëfilltë, të një fëmije që del nga shkolla dhe se cila është ngarkesa mësimore e tij gjatë pasdites që ka përpara, do të bindeni që këta fëmijë masakrohen me një ngarkesë pedagogjike mesjetare.

Ky që po ju them nuk është një konstatim *ex cathedra*, siç quhet zakonisht, lexon diçka nga larg dhe e merr. Rastësia më ka sjellë të kem një nip, të cilin, për shkak të afeksionit, e ndjek në mënyrë të përditshme dhe bashkë me të ndjek edhe sistemin arsimor, së paku nga

klasa e parë deri në klasën e nëntë. Kam fatin të bëj një monitorim të përditshëm. Kam një mundësi mbështetëse, sepse dy prindërit e mi janë pedagogë shumë të vjetër. Unë e di, në kohët e sotme nuk ka ndonjë respekt shumë të madh për këta që kanë eksperiencë të gjata pedagogjike, sepse konsiderohen si eksperiencë të prapambetura dhe eksperiencat e reja kanë hedhur poshtë gjithçka që pedagogjia ka ndërtuar me themele të forta, ndonëse ka rezultuar e kundërta.

Çfarë ndodh realisht? Në qoftë se një fëmijë ka vërtet ekzigjencën që të kryejë mësimet e tij (jo fëmijë që i marrin librat i kthejnë përmbys dhe shkojnë në shkollë tafti-bafti), nuk i mjaftojnë 5-6 orë. Me 5-6 orë ky fëmijë është i ezauruar, ka neveri për shkollën dhe shikon me urrejtje fiktive (jo të drejtë) mësuesit, se janë ata që e prodhojnë ngarkesën dhe detyrohet në shumë raste të ketë sot për nesër deri në 3 teste.

Këto që po ju them, me data, me orë, me firmë dhe me temat përkatëse, ia kam bërë me dije edhe Kryeministrit të vendit. Madje, aq jashtë kontrollit tuaj janë këto gjëra, sa që u jepen fëmijëve të interpretojnë ese në klasën e 7, po them, tekstin e plotë të eseve. Ia kam komunikuar Kryeministrit dhe i kam thënë miqësisht: e interpreton dot (se kishte të bënte me lexim letrar), se unë kam 2 të letërsisë që kanë mësuar tërë dynjanë dhe nuk i interpretojnë dot? Ti e interpreton dot? Për fat të keq, në atë moment kemi qeshur, por kemi qeshur për disa fëmijë, të cilëve u është dashur të bëjnë interpretime që kanë qene *domene* për t'u diskutuar në universitete dhe ua japin në mënyrë të papërgjegjshme fëmijëve në një moshë të caktuar.

Po ju them, një reformë, që nuk monitorohet, që nuk është realiste, krijon ngarkesa të jashtëzakonshme, të cilat në fund fare kanë një rezultat: vrasin fëmijërinë e fëmijëve. Të gjitha reformat e tjera nuk kanë asnjë lloj vlere.

Bota (ju e njihni, ne nuk mund të kontrastojmë) ka një qasje shumë të rreptë drejt uljes maksimale të ngarkesës pedagogjike te fëmijët, për mosmbingarkimin e tyre dhe për të çuar në ngarkesa graduale, që do të shkojnë deri në arsimin universitar. Ka reforma drastike. Spanja është në ballë të kësaj gjëje, për t'i minimizuar këto mbingarkesa, ndërsa ne e kemi kthyer arsimin në një arsimim mesjetar. Kjo është realja. Kjo është e vërteta. Ky është halli i mijëra prindërve, që nuk i shtrojnë dot fëmijët të mësojnë me zor, sepse fëmijët janë të ezauruar nga një ngarkesë pa kuptim, e mbushur me libra, me tekste dhe me detyra, që janë jashtë të gjitha mundësive reale, psikofiziologjike, për ta përballuar atë ngarkesë.

Reforma e pilotuar... Reformat nuk pilotohen në të gjithë territorin. Reformën, të cilën ju e morët nga Kosova, Kosova e pilotoi në një grup shkollash. Shqipëria e bëri tek të gjitha shkollat. I ashtuquajturi “modeli anglez”.

Prandaj, këto gjëra, ndërmjet qasjes dhe atij terreni, miqësisht po jua them: shkoni dhe shikojini.

Kanë siklet prindërit? Po, kanë siklet prindërit t'ju shkruajnë dhe t'ju ankohen. E dini pse kanë siklet? Kanë siklet nga ajo që tha zonja, se kërcënohen me nota. Ky që u ankua, bam-bam. Ai meriton diçka më shumë. E godasin te nota. Krijohet një dëshpërim familjar, ju e dini të gjithë. I ulet nota padrejtësisht ndonjërit prej fëmijëve tanë? Është dëshpërim për gjithë familjen, një familje, e cila ndodhet... Dhe çfarë ka ndodhur? Është traumë për fëmijën.

Unë, sot e kësaj dite, në këtë moshë kur duhet t'i kisha harruar, mbaj mend padrejtësitë e fëmijërisë sime, kur më kanë vënë një notë të vetme dhe kujt do që është i përgjegjshëm i lë shenjë. Këtu thuhet se 12% kërcënohen me notë. Prandaj them që adresojini këto çështje. Nuk na duhen fiktivitete të mëdha, na duhet materia.

Të gjithë këta fëmijë i mësojmë, i ngarkojmë në mënyrë çnjerëzore dhe kur dalin nga shkolla nuk kanë mundësi të artikulojnë. Nuk kanë elementet kryesore të formimit të tyre. E kanë të mbushur memorien e tyre me një sërë detajesh pa fund. Kur marrin një libër historie, fëmijët shqiptarë detyrohen të mësojnë të gjitha datat. E dinë historinë e Egjiptit më mirë se një egjiptian, se po shikoja tekstin e radhës.

Po ju them, madje jam i bindur për këtë, pasi e kam monitoruar pothuajse në mënyrë të përditshme, sepse doja të shikoja çfarë ndodhte dhe e kam konsultuar, është një gjë shumë e madhe për ta traumatizuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pa fund, mor!

Duhet gjashtë orë, mor!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë gjashtë orë, me nga gjashtë lëndë nga katër faqe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos nuk mëson, Liri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ore, gjashtë mësim, sot për nesër...!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, thashë, konstatim.

Klodiana Thartori – Pa e zgjatur shumë, meqenëse jemi edhe në përfundim të seancës dëgjimore, vij nga qendra “Fëmijët sot” – Rrjeti Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve.

Pa diskutim, të gjitha çfarë u thanë këtu janë të mirëpritura, janë çështje që prevalojnë dhe kur shihen nga institucione të ndryshme, çështjet marrin perspektiva të ndryshme. Gjithsesi, nga pikëpamja jonë, si shoqëri civile, dhe nga ajo çfarë kemi ndeshur në të përditshmen tonë në terren, për ta vazhduar diskutimin pak më shumë në lidhje me këto çështje vitale, sidomos ato që kanë të bëjnë me jetën e fëmijës gjatë kohës së qëndrimit në shkollë, sepse është pjesa më e madhe praktikisht ku fëmija kalon ditën e tij, përveç ngarkesës që fëmijët ndiejnë, ne kemi pasur shumë probleme, në fakt, edhe me ngarkesën që ndiejnë mësuesit për shkak të ngarkesës administrative, kërkesave pafund nga DAR-ZA-të, kërkesës së vazhdueshme për të dhënat, për të cilat mësuesit nuk janë asnjëherë të gatshëm të kuptojnë për çfarë shërbejnë dhe kërkojnë. Pra, ekziston kjo, gjithsesi, domethënë është ndeshur gjatë punës në terren.

Tjetër gjë, që, në fakt, duhet përmendur në kuadër të ligjit të ri “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, ligji parashikon, me detyrim, raportimin e rasteve të dyshuara, për të mos thënë më pas të konfirmuara, të dhunës ndaj fëmijëve në shkolla nga profesionistët. Kjo gjë, në fakt, nuk ndodh, pasi mësuesit janë shumë të interesuar, sidomos drejtorët, për të ruajtur emrin e mirë të shkollës, pra të mos nxjerrin rastet, por, sa të munden, t’i mbajnë rastet brenda shkollës, për hir të ruajtjes së reputacionit që ata duhet të kenë si institucion arsimor apo për të treguar se punojnë ashtu siç duhet. Këto janë fakte nga e përditshmja dhe ndeshen çdo ditë në terren.

Kemi një agjenci...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, janë fakte, sepse ne punojmë në...

Kemi një Agjenci Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve, që është institucioni kryesor për mbrojtjen, respektimin, raportimin dhe monitorimin e të drejtave të fëmijëve në këtë vend. Kemi një institucion pa titullar që prej shtatë muajsh tashmë.

Duke qenë se ky është vendi i titullarëve, ku titullari ka shumë rëndësi që të jetë si figurë, në mënyrë që gjërat të lëvizin dhe të ecin, mekanizmi i menaxhimit të rasteve ka ngelur në vend. Është shumë e vështirë të identifikosh një rast abuzimi fëmije, ku rasti të marrë zgjidhje dhe të ketë vijueshmëri. Është pikërisht ajo që thanë, në fakt, kolegët, se rasti mbetet vetëm në nivel identifikimi. Na rroftë që i identifikojmë, sepse, nga njëra anë, përdorim dhe krijojmë statistika, ndërsa, nga ana tjetër, nuk kemi zgjidhje të qëndrueshme, pasi mekanizmat nuk lëvizin dhe ngelim thjesht në nivel procedure!

Pra, ne jemi bërë të gjithë burokratë, proceduralë. Ne jemi shumë korrektë për sa i përket anës procedurale-burokratike, por kur i shikon gjërat me syrin e rezultatit, lë shumë për të dëshiruar.

E fundit, për të sjellë këtu dy-tre shqetësime lidhur me mungesën e kulturës së raportimit, që, në fakt, është zemra e të gjitha çështjeve, nga konsultimi që kemi bërë me prindër, me profesionistë dhe me mësues, disa nga faktorët që kanë të bëjnë me mungesën e kulturës së raportimit lidhen me mungesën e informacionit në lidhje me mënyrën dhe vendin e raportimit. Pra strukturat njihen, mund të ekzistojnë në drejtori arsimorë, në bashki, mund të ketë edhe shërbime të tjera në komunitet, që nuk njihen as nga profesionistët e fushës, as nga mësuesit, as nga prindërit. Pra, është shumë e nevojshme që kjo gjë të ndodhë.

Tjetër faktor që ka të bëjë me mungesën e kulturës së raportimit lidhet me frikën e pasojave të raportimit. Ne jemi vendi i vetëgjyqësive, ku guxo të raportosh një gjë, që ka të bëjë me shqetësime pak a shumë personale, se çështjet e abuzimit ndaj fëmijëve janë të natyrës “Më takojnë mua t’i menaxhoj, është problemi im, pra di unë se si i zgjidh”, është shumë e vështirë të raportosh, sepse, sigurisht, ke edhe frikë nga mënyra e raportimit; me zgjidhjen për të mos u përfshirë: pse duhet të merrem unë me probleme që, tek e fundit, nuk kanë të bëjnë me mua, sepse jeta e një fëmije nuk është ndonjë gjë shumë e rëndësishme; me zgjedhjen për ta mbajtur fenomenin të fshehur, kjo vlen kryesisht për prindërit, sidomos kur diskutohet për rastet e abuzimit seksual. Domethënë, unë zgjedh me vetëdije, kjo është tabu, unë e mbaj këtë gjë brenda mureve të shtëpisë, sepse kjo gjë më përket mua. Pra, duhet ta mbaj të fshehur, sepse na turpërohen vajzat kryesisht.

Një tjetër gjë, që e kemi ndeshur gjatë punës dhe që është shumë e rëndësishme të thuhet se janë kryesisht vajzat ato që stigmatizohen dhe mendohet se rastet e abuzimit seksual ndodhin, sepse kryesisht vajzat e kërkojnë këtë gjë vetë. Pra, perspektiva, qasja dhe perceptimi komunitar është: kanë bërë diçka vetë këto, të cilave u ka ndodhur kjo gjë. Pra, stigmatizimi është i shumëfishtë.

Një tjetër problem që doli nga kolegët, është mosbesimi i fjalës së fëmijëve. Kjo ka të bëjë me krijimin e mënyrës së komunikimit prind-fëmijë. Është shumë e nevojshme të ngjallet si kulturë dhe të krijohen vërtet mekanizmat realë që prindi ta dëgjojë me kujdes fëmijën dhe ta kuptojë kur fëmija relaton diçka me gjuhën e vet, ashtu siç fëmija flet dhe ta trajtojë seriozisht dhe të mos mendojë, se këto janë fjalë fëmijësh dhe nuk janë relevante.

E fundit fare është në lidhje me atë që tha zoti Vasili, që ka të bëjë me mungesën e modeleve të suksesshme të raportimit në komunitet. Për sa kohë nuk ka evidenca dhe shembuj, që gjërat të marrin zgjidhje dhe kjo të jetë e evidente, do të jetë shumë e vështirë që ne të arrijmë të krijojmë modele të qëndrueshme dhe pastaj të kemi një impakt, të cilin e dëshirojmë të gjithë.

Faleminderit!

Petrit Vasili - Faleminderit!

Kush ka diçka për të shtuar?

Urdhëroni, zoti Kolgega!

Shpat Kolgega – Unë nuk dua ta kthejmë në debat, se duket sikur kemi ardhur për debat. Ne nuk kemi ardhur për debat, por kemi ardhur për të dëgjuar dhe për të marrë këshillat, rekomandimet dhe shqetësimet tuaja, që janë edhe tonat të përditshme. Kështu, nuk dua që ta kthejmë në debat perceptimesh edhe historinë e arsimit, sepse pastaj hyjmë në pjesën e cilësisë së arsimit, të mësimdhënies etj.

Meqenëse kryetari parashtroi çështjen e ngarkesës, desha t’ju informoj ju dhe komisionin, se pjesa e ngarkesës së fëmijëve ka qenë një shqetësim kryesor i Ministrisë së Arsimit dhe për këtë shkak u ndërmor edhe nisma, që sot zbatohet në të gjitha shkollat: 3 lëndë në 6 orë. Pra, nuk ka më 6 lëndë në 6 orë, e cila ishte një ngarkesë përtej normales, sidomos për fëmijët e vegjël.

Sot që flasim në çdo klasë, në çdo shkollë të Shqipërisë deri në maturë, bëhen 3 lëndë në ditë, pra fëmijët nuk kanë më për të mësuar 6 lëndë për të nesërmen, por kanë vetëm 3 lëndë. Kjo është një kërkesë direkte e prindërve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, kjo e ul ngarkesën. Nga të gjitha vizitat që kemi bërë nëpër shkolla (ju garantoj se jemi çdo ditë në shkollat e ndryshme të Shqipërisë), shohim një reagim shumë të mirë të prindërve, të mësuesve. Gjithashtu, reagimi më i mirë është i nxënësve, sepse ndihen më të relaksuar gjatë orës së mësimi. Nuk është bërë vetëm kufizimi 3 lëndë në 6 orë, por ka ndodhur një ndryshim në metodën e mësimdhënies. Pra, planet mësimore të mësuesve tashmë nuk janë më si më parë, që hyn mësuesi në klasë, pyet 5 veta me regjistër, i ul dhe pastaj fillon të shpjegojë mësimin dhe më pas mbyll regjistrin dhe ikën në shtëpi, por sot mësuesi shkon në klasë me një metodologji për ta bërë orën interaktive.

Sigurisht, kjo do kohë të zhvillohet, sepse nuk duhet të harrojmë sistemin arsimor nga vijnë dhe metodën e vjetër të mësuesit hijerëndë, i cili i bënte të dridheshin të gjithë kur hynte në klasë.

Sot e them me bindje se kjo ka ndryshuar, sepse kam parë me dhjetëra shkolla në fshatra, në qytete dhe në të gjithë Shqipërinë metodën e mësimdhënies në pjesën më të madhe të shkollave.

S’mund të them që është për çdo mësues kështu, sepse ka mësues 50-vjeçarë, të cilët e kanë të vështirë ta ndryshojnë metodën e vjetër të mësimdhënies, por mësuesit e rinj që futen në shkolla, janë të gjithë të detyruar të aplikojnë metodat moderne të mësimdhënies, ku bëhet mësimi në mënyrë interaktive (me pyetje, me përgjigje, me seminare dhe me lojëra për ta kuptuar më mirë mësimin).

Kjo shkon paralelisht me reformën që është bërë dhe do të zbatohet vitin e ardhshëm për fakultetet e edukimit. Ata që do të shkojnë në këto fakultete, duhet ta kenë mesataren mbi 7. Pra, nuk mund të shkojnë më në fakultetet e edukimit katranjosët apo pesanjosët dhe të bëhen mësues.

Ndërkohë, nxënësve me mesatare mbi 9, që do të shkojnë në këto fakultete të edukimit, Ministria e Arsimit do t'ju paguajë tarifën e studimit për të gjithë periudhën e studimit dhe ata do të subvencionohen nga kjo ministri. Kjo bëhet për të rritur kualitetin në mësimdhënie dhe për të nxitur të gjithë ata nxënës që janë të shkëlqyer që ata të studiojnë dhe të bëhen mësues që ne të kemi mësues më të mirë. Sigurisht, kjo do kohën e vet sepse ne nuk mund të nxjerrim mësues të këtij niveli për një vit, por besoj se për 3-4-5 vjetët e ardhshëm, mësuesit që do të kemi, do të jenë shumë herë më cilësorë se mësuesit që kemi, sepse të gjithë jemi koshientë që vitet e kaluara ka hyrë mësues kush ka dashur. Ju e dini shumë mirë që mjaftonte të kishe dëshirë, blije një diplomë dhe bëheshe mësues. Sot ka ndryshuar e gjithë metodologjia si të bëhesh mësues, madje është më e lehtë të bëhesh mjek. Duhet rreth 6 vjet të bëhesh mësues, duhet të bësh arsimin 3-vjeçar, masterin 2-vjeçar, 1 vit praktik, të marrësh licencë nga Ministria e Arsimit dhe më pas do të hysh në portal. Besoj se filtrat janë bërë shumë mirë për të nxjerrë mësues më cilësorë, të cilët, në fund fare, shkojnë edhe te pjesa e mbrojtjes së fëmijëve, e edukimit më të mirë të tyre dhe rritjes së cilësisë në përgjithësi.

Megjithatë, e thashë këtë meqenëse u hap si diskutim, por nuk do të doja të bëhej debat midis nesh, sepse, siç e thashë në fillim, më shumë jemi për të dëgjuar. Ekzekutivi, por edhe deputetët, kanë më shumë nevojë të dëgjojnë sesa të flasin dhe të japin mend.

Faleminderit, kryetar!

Petrit Vasili – Faleminderit!

Zoti Kolgega, ne do të japim edhe mend, nuk jemi të privuar nga kjo gjë. Pikërisht ky shkëmbim reciprok, që japim dhe marrim mend, është arsyeja e një dëgjese, pasi, në të kundërt, as të ftuarit nuk kanë pse të vijnë këtu, nuk kanë pse na dëgjojnë ne dhe as ne nuk kemi pse t'i dëgjojmë.

Kam dy-tre konsiderata shumë të thjeshta dhe të përqendruara:

Duhet të dini se të gjithë reformatorët e mëdhenj të arsimit në botë nuk kanë qenë të rinj, por kanë qenë 50-55 vjeçarët, të cilët nuk ua mbushin syrin sot, por do t'jua mbushin kur të arrini ju në atë moshë, sepse procesi i reformimit të arsimit është sintezë e një eksperiencë të gjatë pune. Këtë sintezë e ka të pamundur ta bëjë një mësues shumë i ri, sepse duhet të akumulojë për ato nivele që ta përgjithësojë.

Unë e quaj relativisht të papranueshme stigmën me të cilën flitet për moshën në sistemin arsimor. Nuk ka mësues të rinj dhe të vjetër, ka mësues që i përgjigjen ose nuk i përgjigjen standardit të mësimdhënies.

Dihet edhe diçka tjetër, që në të gjithë botën, edhe ku keni studiuar dhe jeni formuar, ky brez drejton elitën e akademisë botërore, sepse të rinjtë duhet të akumulojnë eksperiencë akademike të caktuara, të reflektojnë mbi to dhe më pas t'u komunikojnë të tjerëve. Ndërturja e brezave është një fiziologji e sistemeve akademike, por pjekuria maksimale çmohet dhe nuk përçmohet.

E fundit, ju folët gjatë për sistemin me tri lëndë. Ky sistem është fakt dhe ne nuk kemi në dorë ta ndryshojmë. A është ky sistemi më i mirë? Kjo është diçka e diskutueshme. Pse është e diskutueshme? Orë më të shumta, natyrshëm, janë ngarkesë më e madhe, pasi e njëjta materie që do të jepej gjithë vitin, është përqendruar në një ngarkesë më të madhe për disa ditë. Ka një teori të fiziologjisë, mbi të cilën nuk del dot arsimi dhe asnjë reformë botërore, që aftësia e nxënies, e përvetësimit në një moshë të caktuar, ka kufizimet e saj, ndaj ka lindur edhe ora e shkurtër e mësimi, që nuk është shpikje e shqiptarëve, por ka qindra vjet që ekziston. Pikërisht për arsye se aftësitë e perceptimit nuk janë të larta dhe bie niveli i përthithjes, ju e dini që në sistemin universitar, leksionet që unë kam bërë dikur në moshën time 1 orë e 30 minuta, u braktisën si praktika ezauruese që e ulnin shumë nivelin e përvetësimit. Unë nuk dua t'i futem këtij debati, por le të vlerësohet me objektivitet ky element i ri. Sigurisht, futja e tij në mes të vitit kishte elementet e veta, pasi një ngrehinë e caktuar pedagogjike u përball me një element të ri shumë të fortë të papërgatitur, pasi një sistem i përcaktuar është përgatitur ta respektojë këtë që ka fëmija, sepse, nëse ju do t'i bëni 1 orë e 30 minuta matematikë në ditë dhe 45 minuta janë dy gjëra të caktuara, masa e madhe e koncepteve nuk thithet. Mund ta jepni me urdhër ministri e me çfarë të doni, por aq përvetëson, aq është kapaciteti fiziologjik. Ai e ka më të lartë në të pestën, në të gjashtën, në të shtatën, sepse edukohen sinapset nervore. Pa këto sinapset truri nuk përvetëson. Ne nuk i dalim dot kundër natyrës, ndaj kjo sintezë ka bërë të vijmë këtu. Nuk ka nevojë për debat. Ne shkëmbejmë mendime për të parë, sepse mund të mos rezultojë eksperiencë e duhur dhe mund të rikthehemi. I mençur është ai që reflekton, jo ai që qëndron kokëfortë deri në fund. Megjithatë ky është një shkëmbim miqësor, sepse ne nuk jemi vendimmarrës. Çdo gjë të dobishme që mund të shkëmbejmë, e shikoni më me qetësi duke e harruar kush e tha. Ne nuk po flasim vetëm si njerëz të politikës, por edhe si njerëz me akumulim shkencor. Nuk jemi vetëm politikanë, sepse kemi bërë edhe disa punë të kualifikuara. Kështu që, kur flasim e dimë çfarë kemi akumuluar në jetë.

Megjithatë, qëllimi i mirë i kësaj është të hedhë dritë dhe të shprehë ndonjë shqetësim që kemi.

Keni ndonjë gjë për të shtuar, zonja Bode?

Fjalën e ka zonja Bode.

Edlira Bode – Në fakt, unë e mirëkuptoj shqetësimin e kryetarit për nipin. Po sjell edhe unë përvojën personale. Vajza ime 12 vjeçe është në klasën e gjashtë në një nga shkollat e Korçës.

Zoti zëvendësministër, po ju jap një shembull, që nuk e di nëse është praktikë e konsoliduar në të gjitha shkollat.

Përpara se të vendosej sistemi “3 lëndë në gjashtë orë”, ngarkesa e detyrave të shtëpisë ishte ashtu siç e përshkroi doktor Petriti, por duke bërë presion si prindër nëpërmjet Bordit të Prindërve në shkollë, nga ana e mësuesve pati një reagim dhe ngarkesa e detyrave u reduktua. Pas vendosjes së këtij sistemi, ngarkesa e detyrave të shtëpisë ra menjëherë, aq sa, siç e tha edhe doktor Iliri, ne tani kemi frikën e kundërt, nëse po bëjnë detyra sa duhet apo jo. Tani vajza ime i mbaron detyrat e shtëpisë për gjysmë ore dhe më pas lexon për rreth një orë.

Shqetësimi tjetër imi ka të bëjë me sigurinë apo tematikën që kishim sot. Në shkollë u zgjodh një drejtoreshë e re dhe, në të gjithë të drejtën e saj, vendosi menjëherë rregull që pas orës 08:00 të mos futej në mësim asnjë nxënës, duke i detyruar kështu të shkonin aty në orarin e caktuar.

Kjo gjë vazhdoi deri ditën kur ne ndërhyëm përsëri për të kërkuar që orari të tolerohej, sepse duke i lënë fëmijët jashtë ambienteve të shkollës, rritej pasiguria, edhe pse prindi e dinte që fëmijën e kishte në shkollë. A e keni konstatuar ju një problem të tillë?

Fakti që orari duhet respektuar është i drejtë. Unë mbaj mend që ne shkonim në shkollë në orën 07:30 dhe para se të fillonim mësimin bënim gjimnastikën e mëngjesit. Nuk kishte raste që të mos ishim aty në orën 08:00. Në shkollat tona abuzohet shumë me orarin e fillimit të mësimin. A keni një zgjidhje për këtë gjë?

Petrit Vasili – Nëse mundeni, mund të jepni një përgjigje të shkurtër.

Shpat Kolgegaj – Nuk mund të jap një përgjigje të prerë, por është një gjë fleksible për shkollat dhe drejtuesit e tyre, sepse ka nxënës që vijnë nga fshatrat dhe nuk mund t’ua mbyllësh derën në orën 08:00, se u vonua fugoni, binte shi apo ishte rruga me baltë.

Çdo shkollë duhet të jetë fleksible dhe drejtuesit e shkollave kanë pavarësinë e tyre në këtë vendimmarrje, por kur bëhet fjalë për fëmijë, nuk besoj se duhet të ketë raste kaq ekstreme, si mbyllja e derës së shkollës në orën 08:00, edhe pse kjo gjë varet nga ata.

Për këtë shkak do të fillojë edhe shkolla e drejtorëve ku të gjithë drejtorët do të certifikohen dhe si pasojë do të jenë jo vetëm mësues shumë të mirë, por edhe menaxherë të shkollës.

Kejdi Mehmetaj – Meqenëse zoti zëvendësministër tha që në gjimnazet e rretheve ka tolerancë për këtë gjë, në gjimnazin “Gjergj Pekmezi” ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ju them një shqetësim të të rinjve në Pogradec, që ju ta reflektoni në punën tuaj.

Nxënësit e gjimnazit “Gjergj Pekmezi”, por edhe prindërit e tyre, ishin shumë të shqetësuar, sepse drejtoresha e shkollës ua mbyllte derën e shkollës në orën 08:00 dhe nuk ishte aspak tolerante edhe pse ata vinin nga fshatrat dhe kishin ecur disa orë rrugë në këmbë.

Ne ju kërkojmë që t’i monitoroni këto raste dhe jo të keni një lloj vetëkënaqësie, që ne monitorojmë, shikojmë dhe kemi çdo gjë nën kontroll, sepse situata nuk është e tillë.

Në fshatrat Vilëz dhe Zallbistar, 24 kilometra nga Tirana, kjo reformë nuk implementohet dot, sepse ata fëmijë ecin 6 orë në këmbë për të shkuar në shkollë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e ke këtë informacion, ndaj po jua them.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të shkojmë bashkë dhe do ta kuptosh edhe vetë që nuk e ke situatën nën kontroll.

Petrit Vasili – E qartë.

Nora Malaj – Mund të bëj dy sugjerime, meqenëse kemi zëvendësministrin e arsimit prezent?

Petrit Vasili – Zoti Kolgega, problemi është i tillë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Kolgega, më lejoni të mbaj fjalën time.

Këto janë sugjerime, prandaj ju mbajini shënim dhe i verifikoni. Mund të jenë të vërteta, mund të jenë të ekzagjeruara, por mund të jenë edhe më të rënda se aq. Qëllimi i këtyre seancave dëgjimore është për të marrë më tepër informacion. Deri në momentin që nuk është verifikuar, informacioni mund të jetë edhe kështu, edhe ashtu.

Nora Malaj – Kam dy sugjerime.

Së pari, një nga problemet më të mëdha në Ministrinë e Arsimit është që të gjitha gjërat bëhen me fushata, të pastrukturuara mirë dhe të palexuara mirë. Kjo quhet bullizëm kombëtar. Ti nuk mund të ushtrosh presion për të realizuar një ide, edhe kur ajo nis nga fillimi dhe ti nuk e di nga do të shkosh.

Së dyti, ju folët për shkollën e drejtorëve. Ju bëj me dije se nuk do të bëhet më asnjë lloj veprimtarie nëse nuk do të jetë e bazuar në ligj. Shkolla e drejtorëve është e pabazuar në ligj derisa të ndryshoni aktet nënligjore për arsimin parauniversitar. Jo vetëm shkolla e drejtorëve, por të gjitha institucionet ...

Keni 8 muaj që duhet t'i kishit sjellë aktet nënligjore për ndryshimin e gjërave që duhen bërë, që janë të domosdoshme, të shkruara në strategji dhe nuk keni pse të bëni kërcime pindarike dhe kërkesa për gjëra pa vend thjesht se po themi se do të bëjmë një gjë. Kjo është edhe këshillë, por edhe detyrim yni si komision për të zbatuar ligjin dhe strategjinë, në të kundërt, as strategjia dhe as ligjshmëria nuk do të zbatohen dhe si pasojë do të ngrihen histori, që impaktin më të madh e kanë te qytetarët dhe interesi i tyre.

Kanë marrë një diplomë, por ligji nuk rregullon aktet nënligjore dhe ngelen në mes të rrugëve, nuk dinë ku të interpretojnë situatat e ndryshme, marrin certifikime, por nuk dinë ku t'i interpretojnë dhe realizojnë, marrin kualifikime, por nuk dinë, sepse janë të lëna në mes. Në ministri ekziston një strukturë administrative, e cila nuk është konform zbatimit të politikave të ministrisë. Këto janë tri këshilla të nevojshme.

Petrit Vasili – Zonja Malaj, sot nuk duhet të dalim nga objekti që kemi, ai i impaktit. Ato gjëra që ngritëm këtu, lidhen në radhë të parë me mirëqenien, shëndetin, integritetin e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre. Ato gjëra që sugjeruam për arsimin ishin pikërisht që fëmijëria e fëmijëve dhe arsimimi të mos hyjnë në konflikt me njëri-tjetrin.

Në rast se nuk kemi gjë tjetër, unë mendoj ta mbyllim këtu mbledhjen.

Altin Hazizaj – Ju përmendët shëndetin. Për fëmijët e moshës 6-7 vjeç deri në moshën 15 vjeç Shqipëria nuk mbledh dhe nuk raporton asnjë të dhënë për shëndetin e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili - Rëndësi ka që hapëm disa tema bisedash. Në emër të komisionit ju falenderoj për durimin dhe informacionin e dhënë!

Ju faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA